



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, Viti i VIII i botimit, nr. 119, Shtator 2013
 Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355683191817, internet: www.shoqatadukagjini.org, Kryeredaktor: Lazër Kodra, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

KONFERENCA V E SHOQATËS “ATDHETARE- DUKAGJINI”

2



Ndue Sanaj “Mirënjohja” e Qytetit Shkodër



Ekspozita e hartografise se vjetër nga “Tabula Militaris Itinera

Me datën 16 shtator 2013, në ora 18.30, tek salla “Kardinal Mikel Koliqi”, pranë Katedrales Shkodër, Arqidioqeza Metropolitane Shkodër-Pult, nën kujdesin e Sh. T. Imzot Angelo Massafro, arqipeshkev, në bashkëpunim me famullinë e Shen Shtjefnit Shkodër, Me rastin 1700 vjetorit të Ediktit të Konstandinit (313-2013) hapi ekspozitën e hartografisë së vjetër nga “Tabula Militaris Itineraria” deri tek hartat e Evropës. Ekspozitën e hapi dom Gjovalin Sukaj, famullitari i famullisë së Shen Shtjefnit Shkodër, i cili pas uroj mirëseardhjen pjesëmarrësve, i dha fjalën Monsinjur Angelo Massafros.

6



SIGMA



VIENNA INSURANCE GROUP

Mundësoi Botimin:
GJERGJ LEQEJZA

Ma.di.sh PRODUCTION **Kimay** Produzione Giacche



KONFERENCA V E SHOQATËS “ATDHETARE-DUKAGJINI”

Me datën 28 shtator 2013, në mjediset e bibliotekës së Universitetit “Luigj Gurakuqi”, u zhvillua Konferenca e V e Shoqatës “Atdhetare-Dukagjini”. Në kete mjedis të kulturuar, që na krijon mundësinë Rektorit të Universitetit, profesor doktor Artan Harxhi, Drejtoresha e Bibliotekës së Universitetit, Lida Luka dhe nën kujdesin e drejtpërsdrejt të punonjës së kësaj biblioteke, Arjeta Ferluskaj, u shfaq dhe njëherë serioziteti i pjesëmarrësve: Vlerësimi për punën e Shoqatës dhe vendosmëria për të vijuar punën më tej. Është e rëndësishme dhe e bukur ishte, që të gjitha vendimet, pavarësisht diskutimeve e mendimeve të shprehura ndryshe, u miratuan me konsensus të plote.

Konferenca miratoi propozimet e kryesisë, për disa ndryshime në statut:

1. Në vendimmarrje të shtohet struktura “Këshilli i Shoqatës”. Ai, të përbehet me 31 anetar. Këshilli i Shoqatës zgjedh N/kryetarin dhe Sekretarin e Shoqatës, si dhe anetarët e kryesisë ekzekutive.

2-Zgjedhjet në Shoqatë të behen në çdo pesë vjet. Konferenca zgjedh Kryetarin e Shoqatës dhe anetarët e Këshillit të

3-Shoqata të shtroje funksionin e saj pa afat.

Konferenca miratoi:

1-Planin e Veprimtarive dhe Projekt-buxjetin orientuese të shoqatës për periudhën 2013-



Pjesëmarrësit në Konferencën e V të Shoqatës

2017.

2-Të ndryshohet në formë karta e anëtarësisë dhe brenda muajit dhjetor 2013, anetarët e shoqatës të pajisen me karte të

re.

Konferenca zgjedhi Këshillin e Shoqatës dhe rizgjedhi Ndue Sanaj, kryetarin e Shoqatës, me konsensus të plote.

Anëtarët e Këshillit të Shoqatës “Atdhetare-Dukagjini”, që u zgjedhën me konsensus të plote, janë:

1. Lazer Kodra
2. Prele Milani
3. Ndue Mici
4. Mhill Prroni
5. Anton Kosteri
6. Mri Kroj
7. Ndue Marashi
8. Aleks Dushi
9. Silvana Arrinaj
10. Altin Nika
11. Luigj Shyti
12. Kole Çardaku
13. Prele Shytani
14. Roza Pjetri
15. Dukate Bregu
16. Agron Hasanaj
17. Dede Vuksani
18. Ndoj Mhilli
19. Gjergj Leqejza
20. Angjelina Shllaku
21. Agustin Pellumbaj
22. Tomi Delija
23. Edita Ferluskaj
24. Tringa Rapi
25. Zef Gjeta

Kryetari i Shoqatës, Ndue Sanaj dhe kryetarët e degeve. Ndue Vata, Zef Bari, Syka Çarku, Fran Molla dhe Mirsh Ftoni, janë drejtpërsdrejt anëtar të Këshillit të Shoqatës.

Kjo Konferencë tregoi dhe një herë vendosmërinë për të thelluar punën e shoqatës, gjetjen dhe venien në funksion të formave të reja të punës në të mirë të realizimit të misionit të shoqatës, në gjithë komunitetin dukagjinaz, shkodranë dhe më gjere.

Urime Shoqatës “ATDHETARE DUKAGJINI”, në realizimin e misionit të saj!

Redaksia

PLANI I VEPRIMTARIVE TË SHOQATËS “ATDHETARE-DUKAGJINI” për periudhën 2013-2017

*Vijimi i botimit të gazetës “Dukagjini” në çdo muaj dhe të bëhen përpjekje që të botohet dy here në muaj, ...

*Të marren masa për të përkujtuar 100 vjetorin e rezistencës së Dukagjinit kundër ushtrive malazeze dhe 100 vjetorit të vrasjes së Mehmet Shpendit, si dhe të 90 vjetorit të lindjes së Mar-

tin Camaj, duke bere përpjekje për ngritjen e monumenteve për këta kolos të Dukagjinit, muaji korrik 1915.

*Të bëhen përpjekje për përgatiten dhe dhënien e 2 emisione televizive në vit për kontribute të Dukagjinit e dukagjinazve në shekuj.

* Të botohen deri dy libra në vit.

* Te përgatiten dhe behen deri në dy inskurSIONE në vit, me të rinj e te reja.

*Në çdo tri vjet të përgatitet dhe zhvillohet një simpozium shkencor

*Të përgatitet dhe zhvillohet një here në dy vjet një koncert folklorik në teatrin “Migjeni” dhe gjate kësaj periudhe të zhvillohet një në Tirane.

*Të përgatitet dhe te zhvillohet një veprimtari, me titull “Dita e Alpeve”, në vitin 2016, në të cilën të përfshihen shfaqje artistike, panair, lojëra popullore dhe të tjera.

*Të organizohen veprimtari përkujtimore

*Të përgatiten dhe zhvillohen ceremoni për paraqitjeve të librave të rinj


*Marrja pjesë në Manifestimin “Zëri i Vël-lazërimit”, në çdo dy vjet.

*Të bëhen përpjekje të hapet zyra turistike për informacion dhe drejtim e shoqatës në Shkodër brenda vitit 2014.

Redaksia

ROLI I INDIVIDIT DHE I KOMUNITETIT TË ECIN NË UNITET ME NJËRA –TJETRËN

(FJALA E KRYTARIT TË SHOQATËS “ATDHETARE-DUKAGJINI”, MBAJTUR NË KONFERENCEN E V TË SAJ)



NDUE SANAJ

Të nderuar delegate të Konferencës se V të Shoqatës!

Vijmë në këtë konference me realizime jo të pakta. Madje dhe ne, Kryesia e Shoqatës, që kemi drejtuar, kur ndalemi dhe shikojmë arrijtjet në këto 10 vjet, themi: Vërtetë, ne i kemi realizuar këto veprimtari, që disa prej tyre, po ti kishin organizuar e realizuar struktura të shtetit dhe mund të thoshim mire!

Në ato arritje, është mendimi i juaj, munda i juaj, dhe në veçanti i anëtarëve të kryesisë, për të cilën ju falënderoj dhe ju jemi shume mirënjohës. Ju themi, ju jemi shume mirënjohës, jo se nuk është detyrë e anëtarit të shoqatës të punoje, është detyrë e anëtarit të kryesisë të punoje, por duke qene gjithçka vullnetare, gjithçka pa shpërbtim, mirënjohja është më e plote, mirënjohja është më shpresëdhënëse për të ardhmen e realizimit të misionit të Shoqatës.

Arritjet në këto 10 vjet janë të shumte, por disa po paraqes në këtë Konference:

Së pari, Kryesia e Shoqatës pasi vendosi të nxjerre gazetën e pagëzuar me emrin “Dukagjini”, që nga numri i pare, në muajin dhjetor 2003 e deri me sot nuk është ndalur dhe në këtë fund muaji del numri 119 i saj, fale përkushtimit të redaksisë së saj i drejtuar nga Prele Milani e Lazer Kodra dhe mbështetjes financiare të shume dukagjinaseve, por kryesisht të Ndue Ftonit, të Gjergj Leqezes e Mhill Prronit, të cilët tashme janë “NDERI” i shoqatës.

Së dyti, Me këtë program, me këtë steme, me këtë flamur, shoqata jone është bere e njohur gjithandej dhe ka dhënë kudo kontributet e saj, Ajo, sot ka marrëdhëniesh në gjithë hapësirën shqiptare, në veçanti me shoqatën e miqësisë Kosove-Malësi e Madhe

”Martin Dreshaj, me qendër në Peje;

Së treti, Shoqata është anëtare themeluese e Klubit Shqiptar të Medias dhe të Grupit të Veprimit Lokal “Bjeshkët e Nemuna”

Së katërti, Kemi pasur një korespondence mjaft të gjere me strukturat e shtetit shqiptar dhe deri me Papatin;

Së pesti, Shoqata ka përgatitur dhe zhvilluar 7 simpoziume shkencore;

Së gjashti, Shoqata ka zhvilluar ceremoninë e paraqitjes së 56 librave.

Shoqata në këto vite nuk ka bere asnjë shpikje shkencore të veçante, aspo të ketë pushtuar

ndonjë maje, por ka arritur që sot të kemi një moral tjetër, gjerat ti shikojmë me më optimizëm drejt emancipimit të shoqërisë, drejt shoqërisë së hapur, në themel së cilës janë vlerat e individit, por dhe roli i individit dhe i komunitetit të ecin në unitet me njëra-tjetrën.

Në cilësinë e Kryetarit të Shoqatës dhe me miratim të Kryesisë së Shoqatës, në këtë Konference pune do të ndalemi në disa probleme që na kane shqetësuar në këto 10 vite jete të saj:

Së pari, Shoqata “Atdhetare-Dukagjini” ka punuar në baze të një statuti, në të cilin janë të përcaktuar detyrat e të drejtat e secilit anëtarë të shoqatës, të secilit anëtarë të strukturave drejtuese. Por, nga disa anëtarë të shoqatës, kërkesat e statutit nuk zbatohen. Më e keqja është se, këtë problem e kemi ngritur dhe në raste të tjera, duket se, ose ne nuk kemi ditur të kërkojmë, të organizojmë, ose disa anëtarë të shoqatës kane ardhur në shoqate për “luks” dhe ne kemi rene në prehrin e tyre, në veçanti kryetaret e degëve.

Në nenin 7, përcaktohet: “... Kuota vjetore do te jete 1 000 leke ne vit ...”.

Çfarë ka ndodhur? Kane paguar kuotën në tërësi anëtarët e kryesisë, rreth 22 % e anëtarësisë. Kjo done të thotë: Nga rreth 215 000 leke të arkëtohen në vit nga kuota e anëtarësisë, me te cilat shoqata do te kishte një zyre pune, e cila tani është bere e domosdoshme, mund të botoheshin 1-2 libra në vit, ndoshta dhe ndonjë numër gazete, janë arkëtuar mesatarisht rreth 30 000 leke në vit.

Anëtar shoqate do të jete vetëm ai që zbaton kërkesat e statutit. Për këtë, kërkojmë që anëtarët e shoqatës të pajisen me karte të re anëtarësie. Në mbledhjet e anëtarësisë në baze dege për zgjedhjet në dege, do të paraqiten duke pasur me vete një foto pasaporte

dhe kuotën për vitin 2013. Ndërsa ata, që për një pamundësi apo arsye tjetër personale nuk merr kartën e re, përsëri të aktivizohen dhe do të jene veprimtare në veprimtaritë e shoqatës.

Së dyti, Në nenin 3, përcaktohet: “*Degët e shoqatës krijohen mbi baze rrethi, ... në hapësirat shqiptare ... dhe në diasporë, kur ka mbi 8 vete. Ato derdhen në llogarinë e shoqatës 50 % te të ardhurave të tyre që sigurohen sipas statuti, pjesa tjetër përdoret për nevojat e degës sipas këtij statuti dhe ligjeve në fuqi. Kur veprimtaria e degëve është në kundërshtim me statutin dhe ligjet në fuqi, Kryesia e shoqatës thërret Konferencën e Përgjithshme të jashtëzakonshme dhe merre masa deri në ri-regjistrimin e degës*”.

Ky nen i statutit nuk zbatohet nga degët, me përjashtim të degës së Tiranës, e cila ka filluar të lëvizë, të zhvillojë veprimtari, por anën financiare asnjëra dege nuk e ka zbatua, nuk kujdesen as për gazetën, në veçanti dega e Lezhës dhe e Kurbinut. KESH nuk ecet. Prandaj degët duhet të riorganizohen dhe të fillojnë nga puna. Punën do ta fillojnë duke u orientuar nga programi i përgjithshëm i shoqatës në kushtet e tyre specifike se, secila dege ka specifikën e vet

Së treti, Shoqata nuk është krijuar të pengojë bashkëpunimin në mes dukagjinaseve, përkundrazi, ti bashkojë ata për ti dhënë emrin që meriton Dukagjini. Të ndare, të përçarë nuk mund të zësh vendin që të takon. Pse, ndodh kjo? Ne, jo në pak raste mbesim peng e së kaluarës! Ne, duhet ta respektojmë të kaluarën, ta studiojmë dhe të përgjithësojmë vlerat që duhet t’u trashëgoen brezave. Ne, nuk duhet të ecim me mendime orientale, të cilat po na ndajnë nga njeri-tjetri, duke vu në mes të këtij bashkimi “UNIN”. Një personalitet theksonte: “... Unë, unë, përsëri unë, prape unë ...”. Eh, ky i shkretë uni, që na le në vendnumëro, nuk na le të bashkohemi. Mentaliteti oriental, ka “PERJASHTIMIN”. Kjo do të thotë, kush nuk është në një mendje me mua, përjashtohet, është armiku i im dhe si i tille duhet të asgjësohet. Kjo nuk është tradicionale, nuk është fetare, nuk është ligjore.

Si është e mundur, që Malësia e Madhe, Nënshkodra, Bregu i Matës kane ndryshuar ritet mortore, ndërsa ne dukagjinasi vijojmë! Pse? Ne, nuk po zbatojmë ato që kemi trashëguara, por i kemi thelluar keqas?! Mos valle, kush ka te drejte? Kemi ne, apo banoret e krahinave fqinj? Secili nga ne, në këtë Konference dhe jashtë saj, do të thotë: Ne nuk kemi të drejte!

Si është e mundur, që kërkohet shkol-

lës të ndërtuar në lagjen “Mark Lula”, të pagëzohet me emrin e lagjes, të një figure historike, që duhet respektuar e nderuar për kontributin e tij, prandaj një lagje, kryesisht me dukagjinasi, në qytetin tone, është pagëzuar me emrin tij. Por nuk mundet, që me emrin e tij të pagëzohet dhe shkolla 9 “Vjeçare”. Shoqata ka kohe që ka propozuar: Kjo shkolle të pagëzohet me emrin e njërit nga luftëtarët më të veçante për liri, për fjalën e lire, siç është emri i profesor Kole Preles, i cili pengohet politikisht nga disa dukagjinasi primitiv.

Si është e mundur, që ende vijojmë të vrasim?! Në periudhën, 1991-2012 janë vrare për arsye te ndryshme 145 vete, në mes tyre 15 femra. Dukagjinasi, a besojmë në fenë katolike, ai njohim 10 urdhnimet e Tenzot, që në urdhnin e peste, theksohet “... mos vra se, me Tenzon hynë në gjak ...” Pse kërkojmë të zgjidhim këtë fenomen me metoda arkaike, kur është shteti i demokracisë? Një qëndrim i tille, është i papranueshëm.

Mund të ketë dhe të tjera problematika, me të cilat duhet të punojë shoqata nëpërmjet formave të veta, që të ndikojë sa më shume në emancipimin e shoqërisë. Pa punuar në këto drejtime të gjithë strukturat dukagjinase, shoqata, komuna, arsimtari e të tjerë, më në krye intelektualët dukagjinasi, duke bashkëpunuar edhe me intelektualët shkodrane, tiranas apo me gjere, nuk mund të realizojmë misionin e shoqatës. Intelektualët dukagjinasi, nuk duhet ta quajnë të zgjidhur problemet, pse vete kane zënë ndonjë vend pune te mire. Ne, vërtetë jemi dukagjinasi dhe e quajmë veten krenar, por nuk mjafton kjo. Duhet punuar për të merituar veten dukagjinasi. Është lehte të themi: Dukagjini krenaria e ime, dhe ne fakt ne çdo dite vepron kundër vlerave dukagjinase. Dukagjini nuk është epiqendra e shqiptarisë. Ai është pjese e shqiptarisë, e asaj pjese që ka dhënë dhe jep kontributin e vet në këtë nacionalitet dhe kaq. Po, hiqe më larte, nuk merret kush me ty. Çdo hiperbolizim të vlerave, kthehem në primitiv.

Këto janë disa nder problemet, që shoqata në bashkëpunim me intelektualët dukagjinasi, shkodrane e mbare shqiptar, me strukturat e pushtetit vendor dhe atij arsimor, do të punojë më me përgjegjësi për të ardhmen. Prandaj, reforma që mendojmë të bëjmë në strukturimin e saj do ta bëjnë veprimtarinë e shoqatës më të zhdërvjelltë, më aktive dhe bashkëkohore për realizimin e detyrave që kemi përpara

Ju faleminderit!

MJEKU PRELE GJELOSHI, KRENARIA E KOMUNËS SË PULTIT

Në përvjetorin e pare të ndarjes nga jeta të mjekut Prele Martin Gjeloşi, është nderuar nga vendlindja e tij, **Pulti**, me titulli e larte **“KRENARIA E KOMUNËS SË PULTIT”**, pas vdekjes.

Kiri, fshati në të cilin lindi mjeku Prele, është zgjuar i teri në këto dite vjeshte, për të kujtuar birin e tyre të shtrenjtë, mjekun, i cili gjate gjithë jetës së tij ishte në ndihmën e pare mjekësore, që me shekuj e kishin ëndërruar të kishin një mjek të tyrin. Dhjetëra makina ishin nisur nga Shkodra e zona të tjera drejt kishës së fshatit Kir, në komunën e Pultit, për të marre pjese në një ceremoni përkujtimore të organizuar nga komuna e Pultit. Asnjëherë, në këto vite demokracie, kisha e Kirit nuk kishte pasur aq njerëz në një dite për të nderuar një njeri të vetëm, si mjekun Prele Gjeloşi.

Ishte i pranishem kryetari i komunës Shale, Bal Vuksani dhe personalitete të komunës.

Veprimtaria filloi në orën 11.00, me meshën e shenjte kushtuar mjekut Prele Gjeloşi, në të cilën morën pjese pjesëtar të famullisë, të afërme, miq, të njohur dhe banorë të fshatit.

Në fillim, te pranishmit i ka përshëndetur motër Sandra Bertolotto, Anëtare e Nderit e Shoqatës “Atdhetare-Dukagjini”, e cila prej vitesh udhëheq urdhrin e motrave të **“Krishtit Mbrete”**, në fshatin Kir. Në fjalën e saj përkujtimore shprehu respektin për mjekun Prele, për ndihmën e madhe që ju kishte kushtuar të sëmurëve. Ajo kujton shume net që kishte kërkuar mjekun Prele, për të shpëtuar gra në lindje, fëmijë, pleq e të tjerë. Ai, duke udhëtuar neper fshatra e terrene të thyera, për të shpëtuar jete njerëzish duke ju dhënë ndihmën e pare, dhe pastaj duke i nisur natën me shoferin Pëllumb Ndoka për në spitalin e Shkodrës.

Meshën e shenjte e ka celebruar At Fran Deda dhe ky banorë i fshatit Kir, i cili në fjalën e predikimit theksoi: Intelektuali, mjeku Prele Gjeloşi ishte fisnik, ishte i kultivuar me një dashur njerëzore të lindur, ishte shembull për tere banoret e Dukagjinit.

Pas meshës, veprimtaria përkujtimore për mjekun Prele Gjeloşi ka vijuar në mjedisin e kishës, dhe poeti Lulash Brigja ishte ideatori dhe drejtuesi i kësaj veprimtarie. Të pranishmit i përshëndeti kryeplaku i fshatit Kir, Ndre Cubi, i cili ju uroj mirëseardhjen sipas traditës me shprehjen popullore: Mire-se ju ka pru



Zoti e paçi faqen e bardhe! Pastaj tregojë vendimin e banoreve të fshatit Kir, për ti propozuar këshillit të komunës së Pultit, për të nderuar mjekun Prele Martin Gjeloşi, birin e tyre, me titullin e larte **“KRENARIA E KOMUNES PULT, MJEKUN PRELE GJELOSHI”**, pas vdekjes.

Pastaj veprimtaria ka vijuar me një këngë, kushtuar mjekut Prele Gjeloşi, nga rapsodët Fran Kodra e Ndue Shytani, nëpërmjet se cilës sollën për te pranishmit shume ku-

jtime dhe emocione te forta. Më pas, ne emër te Shoqatës “Atdhetare-Dukagjini” ka përshëndetur, kryetari i saj, Ndue Sanaj, i cili është dhe qytetar nderi i kësaj komune. Ne mes te tjerave theksoi, *“Ky nderim që ju bë mjekut Prele Gjeloshit, është një nxitje për gjithë ne, për gjithë shoqërinë, që nen shembullin e shkëlqyer të tij, për të punuar më shume, për Dukagjinin, për dukagjinasi, për komunitetin ku banojmë e jetojmë, që shoqëria e jone të eman-*



cirohet më shume drejt standardeve euroatlantike, drejte një shoqërinë të hapur, në themel së cilës janë vlerat e individit, dhe që roli i individit dhe i komunitetit të ecin në unitet me njëri-tjetrin”.

Për pjesëmarrësit kane sjell kujtimet e tyre Zef Prozhmi e Zef Prela, në marrëdhënie të shkëlqyera me mjekun Prele Gjeloşi.

Kryetari i Këshillit të Komunës së Pultit, Gjin Brigja, i ka dorëzuar titullin e larte për mjekun Prele Gjeloşi **“KRENARIA E KOMUNES PULT”**, pas vdekjes, djalit të tij, Klodian Gjeloşi. Klodiani, në emër të familjes përshëndeti te pranishmit, duke falënderuar Këshillin e komunës, pjesëmarrësit që kane ardhur të nderojnë kujtimin e babës së tyre.

Në këtë veprimtari, Rapsodi Bardhok Perbiba, këndoi një këngë kushtuar figurës së mjekut Prele Gjeloşi, i cili solli mjaft emocione tek të pranishmit.

Në përfundim të kësaj veprimtarie përkujtimore, komuna e Pultit, për të pranishmit shtroi një koktej të kënaqshëm.

Duhet theksuar se, mjeku

Prele Gjeloşi, për punën e tij, për njerëzinë e tij është nderuar nga e gjithë shoqëria, nga i gjithë komuniteti ku ka punuar e jetuar, nga koleget e shkollës e të punës, u nderuar nga komuna e Rrethinave, institucionit shëndetësor në Grudë të Re, ju dha emri **“QENDRA SHËNDETËSORE DR. PRELE GJELOSHI”**, i ka dhënë titullin e larte **“Qytetar Nderi”** të komunës, dhe Shoqata “Atdhetare-Dukagjini” i ka dhënë titullin **“Anëtar Nderi”** i Shoqatës. Ai, mjeku Prele Gjeloşi, do të mbetet simboli i përjetshëm i kësaj komune dhe i Dukagjinit!

Përgatiti Zef Nika

ABRAHAM LINKOLNI I SHKRUAN LETËR MËSUESIT TË DJALIT



NDUE DEDAJ

E cili prind i sotëm nuk do të kishte dashur t'i drejtohej mësuesit të fëmijës së tij, ashtu si Abraham Linkoln mësuesit të të birit para më shumë se një shekull e gjysmë. Na u kujtua letra e tij e famshme në ditën e parë të fillimit të vitit të ri shkollor, në shkollën "Sabaudin Gabrani" në Tiranë, ku qëlloi të ndodheshim mes fëmijësh, prindërisht dhe mësuesish të përfshirë nga emocionet e forta, ani se pas një trafiku të lodhshëm për të shkuar deri te shkolla, të lagur nga shiu i rrëmbyeshëm i atij mëngjesi. Ndërkohë ata njerëz aty dhe të tjerët në mbarë vendin mendjen e kishin përtej ceremonisë së fillimit, te ditët që do të vinin më pas, mbarëvajtja e shkollës, suksesi i saj. Që lulet e ditës së parë të mbeten ashtu të freskëta, se ato "vyshken" nëse humbet sadopak kuptimi i misionit edukativ, fëmijët nuk përkushtohen si duhet në mësim, prindërit e harrojnë derën e shkollës pas ditës

së parë të saj, mësuesit thjesht bëjnë "detyrën", kurse humanizmin, që është motori i shkollarisë së çdo kohe, e hedhin pas krahësh si një vjeturinë. Ja, për të gjitha këto në letërën e Presidentit-prind, apo të prindit-President, ka kumte bashkëkohore, në adresë të mësuesit, këtij edukatori unik, sado të përparojë teknologjia. Ajo letër proverbiale është një kod edukativ shembullor, si të ketë dalë nga pena e didaktëve më të mëdhenj dhe kjo jo vetëm për shkak të personalitetit të Linkolnit, por se ky është zëri i brendshëm i çdo prindi ndaj mësuesit të fëmijës së tij. Letërshkruesi i *kërkon mësuesit shumë gjëra të fisme, morale, filozofike, qytetare, ta mësojë fëmijën e tij për rregullitë dhe çrregullitë e botës. Mësojini tim biri*, shkruan Presidenti, se "për çdo politikan egoist ekziston një lider i përpiktë". Tejet të vështirë e ka ky biri i sotëm i "Presidentit", jo ai matanë Atlantikut, por ky këndej Adriatikut, ta kuptojë këtë sentencë, kur shumica e politikanëve që ai ka parë e dëgjuar kanë qenë egoistë, më e pakta kjo që mund të thuhet për ta. A thua zoti Linkoln ta ketë ndier qysh atëherë se do të vinte një kohë me bjerrje të disa vlerave diturore, që i lutej mësuesit të të birit: "*Nëse mundeni, transmetojini tim biri mrekullinë e leximit të librit, por i lini dhe kohën e mjaftueshme për të kundruar misterin e përrjetshëm të fluturimit të zogjve në qiell, të bletëve në diell e të luleve në një*

kodër" – dy nga dobësitë e mëdha të rinisë së kohës moderne, të lexuarit pak dhe përhumbja në botën virtuale, duke braktisur zogjtë, bletët, lulet, natyrën. Po ashtu zotëria e tij i lartë, i kërkonte mësuesit të djalit që të mundahej t'i kultivonte fëmijës së tij forcën për të mos ndjekur turmën dhe për mos t'u hedhur të gjithë mbi qerren e fituesit. Pikë për pikë kështu shkruan zoti President, si t'i ketë parë turmat në Shqipërinë tonë të pas '90-s, si shtyeshin pas liderëve të tyre egoistë, gjithnjë sipas termave të Linkoln (ne do të shtonim dhe ... historikë!), si vraponin për t'u hedhur mbi qerren e fituesit. (Prandaj këtej nga ne ka parti që njëherë shkojnë majtas e njëherë djathtas në koalicionet qeverisëse, deputetë që një mandat janë rozë e mandatin tjetër bëhen blu, le pastaj nëpunës të rangjeve të mesme e të ulëta, që nuk e kanë për gjë ta ndërrojnë taserën e partisë për karrigen e radhës etj.) E qerrja e fituesit të ri sapo ka nisur të ecë ...

Mund të vazhdohet me të tjera gjëra që burri i shtetit i kërkonte mësuesit dhe kjo është themelorja. Njeriu që drejtonte botën, një legjendë e gjallë e njeridashjes, kombeve e racave, mund t'i drejtohej kombit amerikan e t'ia thoshte të gjitha këto, mund t'iu drejtohej të gjithë mësuesve të kontinentit, mirëpo ai bën një gjë kaq të thjeshtë në dukje, por madhështore në përmbajtje, i drejtohej thjesht

mësuesit të djalit të tij, një njeriu, një edukatori, duke e konsideruar të barabartë me veten, i bindur se mësuesi ishte një president i llojit të vet, sa vetë presidenti i çdo vendi, pasi a nuk mbante firmën e tij në diplomë dhe ky i fundit? Ky ishte statusi i mësuesit amerikan në gjysmën e parë të shekullit XIX, prandaj dhe arsimi atje është sot më i miri në botë. Ka bërë përpara edukimi në këto kohë, shoqëria e shkolla, politika, qeverisja, megjithatë Abraham Linkoln është prapë aty, duke na mësuar se si të flasin me mësuesin e fëmijës sonë, nuk është mplantur aspak mesazhi i të 16-it President të SHBA-së, "*gjigandit të sjellshëm*", siç është quajtur, njeriut që bekoj paqen dhe e mori lufta. Ai vazhdon t'i drejtohet edukatorit kombëtar me solemnitet atëror: "*Mësojini, i nderuar mësues, tim biri të realizojë idetë e tij, të ketë besim të palëkundur në vetvete, sepse vetëm atëherë do të ketë besim në njerëzimin. Mësojini se për çdo kriminel ka një hero. Mësojini se mendjemëdhenjtë janë të parët që humbasin. Mësojini të shoshisë atë që dëgjon me shoshën e së vërtetës dhe të marrë veç të mirën. Mundohuni ta mbani larg zilisë dhe mësojini sekretin e një buzëqeshjeje të çiltër. Të mos pranojë kurrë një çmim për shpirtin. Mësojini se nuk është turp të qash, e të tjera*"

Por të kthehemi këtu, mes nesh, ku arsimi vërtet ka zhvillim, ama buxheti i shtetit për këtë sektor nuk është as sa para '90-s, drejtimi i shkollës është politik e nepotik, mësimdhënia nuk ka dalë nga klishtë tradicionale etj. Ka pasur gjithnjë zotime nga qeveritë se do të bëhej më e mira për pozitën e mësuesit, po prapë figura e tij nuk është në lartësimin e merituar. Meqë dhe tash e mbrapa këto do të jenë

punë qeverie, ne si qytetarë përpigemi të shkruajmë letrën plot me porosi për mësuesin e fëmijës sonë, qoftë ai i klasës së parë, arsimit 9-vjeçar, gjimnazit apo pedagog i universitetit. Bëj më të mirën për fëmijën tim, fëmijët tanë. Bëj që ata ta duan punën, pasi ta themi shqip nuk e duan hiç, të priren dhe nga disa zanate që nuk i kanë për zemër, kryesisht ato që kanë të bëjnë me tokën, pyjet, ujërat, minierat, bujqësinë, blegtorinë etj. U është mbushur mendja top të bëhen veçse juristë, ekonomistë, menaxherë biznesi, gazetarë, arkitektë, si një herë e një kohë, farmacistë. Na i mëso, pra, fëmijët të venë në të gjitha profesionet, të bëhen dhe ashtu si ti, mësues, sidomos matematike, fizike, informatike etj. Na i mëso të ndjekin shkollat e mesme profesionale, të bëhen topografë, teknikë mineralesh, mekanikë, hidraulikë, elektricistë, hotelierë etj. (Flitet aq shumë për turizmin, ka dhe ndonjë fakultet për këtë, por nuk dimë asgjë rreth diplomimit të ndonjë kontingjenti menaxherësh turizmi.) Na i eduko që kur të mbarojnë shkollat të shkojnë e të punojnë dhe në rrethet e largëta, se sado që kanë lëvizur banorët, as Hasi, as Kolonja nuk janë shkukur prej andej ku janë për t'u vendosur në Tiranë, ndaj duan mjekë, mësues, inxhinierë etj.

Dhe sa ka si këto probleme, i dashur mësues. S'na mbetet tjetër vetëm të përsërisim dhe një herë atë që thoshte në mblyllje të letrës së tij zoti Linkoln: "*E di që janë shumë kërkesa, i dashur mësues, por bëni më të mirën që mundeni*".

Marre nga gazeta "SHQIP",
date 21 Shtator 2013

NJI UDHËTIM NË MILISKA

Shume kush ka kalue për në Hidrocentralin e Fierzës. Para se të arrih në Fierze, pa tjetër do të kalosh neper fshatin Miliska, fshat tepër malor, me shkëmbej të mëdhenj, sipër këtij fshati pyje të bukura, uji akull dhe me banore shume bujar, por edhe trima.

Ishte regjimi i egër i Mbretit Zog, por si pasoje e një rasti këtu, në këtë fshat u bë një lufte e ashpër. Xhandarët e Mbretit rrethuan shpine e Deli Pjetrit, kulle dy katesh prej guri. Arsyeja e këtij rrethimi ishte kundërshtimi për një padrejtësi që u bë nga Qeveria. Kështu, nisi pushka në shkëmbinj të Miliskase, shtëpia u rrethua, luftuan për 7 ore, pa ju dorezue ushtrisë me komandant Kadri Mehmetin. Kulla u dogj, nana e Zef Thaçit u dogj në zjarr, por u vranë shume xhandarë, mashkujt shpëtuan dhe u arratisen në Kosove dhe qëndruan atje deri sa mbreti Zog u largua nga Shqipnia. Duke

marre shume jehone kjo lufte mes një shpije dhe një ushtrie e armatosur mire, njerëzit pyetshin: Ku ndodhet ai fshat? Si ka mundësi kjo trimni e rrallë në këtë krahinë? Dikush nga Shkodra vendosi të udhëtoi drejt fshatit Miliska! Ky udhëtar ishte Pader Gjergj Fishta, njeriu që e mori guximin të shoh ketë fshat dhe banoret e tij nga afër. Ai, udhëtoi drejt krahinës së lballës, fjeti aty dhe të nesërmen u nis për në fshatin Miliska. Fishta, shoqërohej nga dy persona që nga Shkodra. Rrugës takojnë një djalë i veshur me rroba tradicionale, i cili nuk e njilhte Pader Gjergjin. Por, kur i treguan se kush ishte, u trondit pak. Kishte degjue për te, por ishte hera e pare që e takonte. U ngrit dhe i puthi dorën, në shenjë respekti. Pastaj, nen drejtimin e djaloshit nisen përsëri për në fshatin Miliska. Bën rreth një ore rruge, po të thuash pa folur njeri me tjerrin nga lodhja, dolën në lagjen Hasanbibaj, i cili shënon fillimin e fshatit. Ulen në hijen e një gështenje. Lajmi shkoje në fshat dhe për pak minuta burrat e lagjes:

Ndue Prendushi, Gjon Prendi, Gjin Nikolli, Zef Ukshini, Mhill Uka e Pjeter Kole Ahmeti, u mblodhën pranë At' Gjergjit. Bën një pushim të gjate dhe biseduan mire e mire. U pyeten për jetën, për banoret, për kushtet e këtij fshati dhe për ngjarjen luftarake. Ndue Prendi, i drejtohet Ate Gjergjit: Ju Atë, do të vini tek unë, në shpine time! Jo, i thotë Atë Fishta, nuk kam për të fjetur në Miliska se, dua të dal në fshatin Arst, te Nik Çuni. Fjalët mbaruan, por Atë Gjergji i tha lajmëtarit, që të lajmëroje Nik Çunin, në atë shpi të mblidhen burrat e fshatit Arst dhe Miliska. Kështu u ba, u nisen rreth 15 burra drejt shpise së Nik Çunit. Kur u afruan te shpija e tij, ju del përpara një burrë faqe kuq, me mustaqe të mëdha, dhe i drejtohet Atë Gjergjit: Atë, mire se të ka pru Zoti me gjithë shoqe! Ai, ishte i gëzuem shume për miqtë, në veçanti për ata që i vinin nga Shkodra. Ajo nate, me biseda nga më të ndryshmet, kaloi në një atmosfere shume të gezueme.

Të nesërmen, Ndue Çuni i kërkon

Atë Gjergjit, me gjithë shoqënuetit të rrinin dy tre net, të pushonin mire e mire dhe pastaj të largohen, por At' Fishta do të largohej, duke ju uruar lumturinë të gjithëve. Ata e përcollën me shume respekt ketë mik, që i nderoi me ardhjen e tij në këto dy fshatra. U mbajt shume vite në zemrat dhe mendjen e këtyre malësoreve.

Kur erdhi Partia Komuniste në fuqi, dihet fati i priftërinjve, që shumica e tyre u pushkatuan, por megjithatë, emri i Atë Gjergj Fishtës, mbeti i gjalle në kujtesa tone. Ishte viti 1946, dikush paditi te sigurimi i shtetit se, në fshatin Miliska gjendet një gështenjë, ku ka ba mbledhjen e fshatit Atë Gjergj Fishta. U pyeten shume njerëz, që të tregonin për këtë kuvend dhe dhanë urdhën të pritet menjëherë kjo gështenjë, por burrat e lagjes nuk treguan dhe gështenja nuk u pre, dhe sot jeton.

Pavarësisht se, çfarë behet në qytete e në fshatra, në Shkodër dhe në Tirane në ketë tranzicion, qoftë në Veri apo në Jug, kujtimet

e së kaluarës mbeten në mendjen e ndërzeve. Në vitin 2011 në qytetin e Shkodrës jeton një person prej Arstit-Miliskaut dhe një tjetër në Tirane, takohen në Shkodër, ulen në fresk, në lulishten përballe bashkisë së qytetit dhe po bisedonin njeri me tjetrin, kur pa pritur atij nga Tirana i sheh syni bustin përballe godinës së bashkisë dhe pyet: Kujt i është kushtuar ai mur? Ky, në Shkodër i thotë: I asht kushtuar Atë Gjergj Fishtës. Po, ky tjetri në forme piramide, kujt i asht kushtuar? –I asht kushtuar Hasan Riza Pashës, i thotë "shkodrani". Ai, në Tirane thotë: Kjo nuk asht e drejte! Njeriut të madh të nacionalitetit tone, të shqiptarisë të përkujtohet me një mure "tullash" dhe pashait turk ti kushtohet një memorial kaq i madh dhe luksoz, jo vetëm që nuk e shikoj të arsyeshëm, por asht një turp për ne shqiptaret. Uroj që koha, krahas të tjerave, të lere prapa ketë tranzicion dhe gjerat ti çojë në vendin e vet.

SHAN SOKOLI

Ekspozita e hartografise se vjetër nga “Tabula Militaris Itinera

Me datën 16 shtator 2013, në ora 18.30, tek sallat “Kardinal Mikel Koliqi”, pranë Katedrales Shkoder, Arqidioqeza Metropolitane Shkoder-Pult, nën kujdesin e Sh. T. Imzot Angelo Massafro, arqipeshkev, në bashkëpunim me famullinë e Shen Shtjefnit Shkoder, Me rastin 1700 vjetorit të Ediktit të Konstandinit (313-2013) hapi ekspozitën e hartografise se vjetër nga “Tabula Militaris Itineraria” deri tek hartat e Evropës. Ekspozitën e hapi dom Gjovalin Sukaj, famullitari i famullise se Shen Shtjefnit Shkoder, i cili pas uroj miresardhjen pjesemarrësve, i dha fjalën Monsinjor Angelo Massafros.

FJALA E DREJTORIT TË BIBLIOTEKES “MARIN BARLETI”, GJOVALIN ÇUNI.

Ka një ngjashmëni në kontekstin e organizatorve të aktivitetit me ngjarjen që përkujtohet. Ftesa që ju dërgohet fillon kështu: “Ne, Imzot Angelo Massafro Arqipeshkv Metropolit i Konferencës Ipeshkvnore Shkodër-Pult (Shqipëri) dhe Imzot Dodë Gjergji, Administrator Apostolik i Prizrenit (Kosovë)... ju paraqesim... etj. Që pra, dy personazhe të randësishëm të Kishës Katolike Shqiptare, na ftojnë të përkujtojmë aktin e marrë 1700 vjet më parë nga dy personazhe potent të botës së lashtë; Konstandini (Flav Valer Konstandini, 274-337) dhe Licini.

Edikti i Milanos, i shpallur nga ato, i dha udhë liris fetare. E ky edikt fillon njisoj si ftesa e jonë: “Ne, Konstandin Augusti dhe Licin Augusti kemi vendosur të garantojmë respektimin e kultit hyjnor... etj, etj”.

Ky vit i kujtun si viti i Konstandinit, ka nisë më s’pari në Milano. Hapsina ku kanë me u zhvillu aktivitetet kushtu kësaj figure dhe këtij edikti përfshijnë të gjitha vendet, ku shtrihej dikur Pe-



randoria romake; tuj fillu nga qytetet e Italis, nëpër vende të tjerë t’Evropës dhe deri në Stamboll t’Turqisë.

Manifestimet, siç shihet, përfshijnë vende dhe kultura të ndryshme, pa privilegju një kulturë nga tjetra, një rajon e një qytetnëm, nga tjetri.

Në këtë udhë (tashmë të fillueme në hapsinat tona shqiptare), mund të thohet me krenari, se vendi jonë ka fatin me kenë i privilegjum mes kombeve të tjerë. Arsyeja asht mjaft e thjeshtë. Konstandini i Madh mendohet me kenë dardan, lindun në krahinat e Ilirisë në Naissus (Nishi) i sotëm i Serbisë në vitin 274. N’ditët tona ekzistojnë mendime të ndryshme nacionaliste të kohës, që përpiqen ta tjetërojnë këtë figurë në dobi të një kombi tjetër. I mbetet historiografisë së sotme shqiptare me u përballë me këtë çështje, por edhe vet shqiptarëve nëse dishojnë

me e vleresu.

Rizgjimi i interesit për këtë figurë, që me të drejtë bota e cilëson të Madh, lidhet me jetën si Perandor dhe me organizimin administrativ të Perandorisë së lodhur romake me luftimin e ndalimin e veseve të këqija, nga të cilat vuntë shoqëria e at’hershme, etj.

Por, dy vendimet më të randsishme, t’cilsueme nga studiues t’ndryshëm epokalë, të aftë për me ndryshu historin kjenë, përshtatja e kristianizmit si religion zyrtar i Perandorisë, dhe transferimi i kryeqytetit t’Perandorisë nga Roma në një qytet të ri të ndërtum mbi themelet e qytetit antik t’Bizantit në vitin 326, Konstantinopojë.

Edikti i Milanos, që u shpall në vitin 313 thuhet të jetë i nxitun nga fitorja për sundimin e Romës mbi trupat e Mesencit, në betejën Saksa Rubras, gjegjësit tek ura Milvo, (28 tetor 312) pas vegimeve që ju shfaqen natën para, dhe ditën e betejës, në të cilën Konstandini n’qiell pau një form kryqi, ku shkruheshin fjalët: “In hoc signo vinces” (Me këtë shenjë ti do të fitosh). Po a ishte vetëm sheja?!... Mendoj se jo. Sheja ishte përfundimi i një lufte të gjatë të krishtenve për t’u ligjësu. Historia e krishtërit kishte filluar që me lindjen e Krishtit me veprat dhe udhëtimet e apostujve, një prej t’cilëve Pali, kaloi në vitin ‘50 edhe nëpër Iliri, kryesisht në krahinën e Zadrimës tuj ungjillizu. Ka kenë një histori e gjatë. Edikti i Milanos i dha fund persekutimeve t’krishtenve, por haptë edhe prespektiva të tjera drejt liris së besimeve, mas një periudhë t’gjatë persekutimesh, ku ilirët, por ma vonë edhe shqiptarët, patën persekutorë perandorë t’kohnave moderne, por edhe fatosa të marterizum; tuj fillu nga Flori dhe Lauri e deri tek martirët e sotëm.

“Ne, Konstandini Augusti, dhe ne Licin Augusti, -thuhej ne edikt- kemi vendosur të garantojmë respektimin e kultit

HARTA TË VITIT 1699, PËRFSHI NË “ATLAS MARIANUS” ME AUTOR H. SCHERER: MAJTAS ITALIA, DJATHHTAS ILIRIA



SHËN KONSTANDIN NAISSUSI DHE EDIKTI I MILANIT I VITIT 313 SHPALLI LIRINË E BESIMIT KRISHTER NË KUADËR TË PERANDORISË ROMAKE

Nga **Reshat AVDIU**

Konstandini i Madh Naissusi 306-337. Konstancë Klori, pati disa fëmijë, kështu me Helenën, e pati Konstandinin e Madh. Me gruan e dytë, Teodorën, të bijën e Maksimianit, e pati djalin Dalmatin, i cili i la dy djem Dalmatin e Ri dhe Hanibalin, të dytë ishin me titull Cezar, pastaj pati Jul Konstancin, i cili i la dy djem Gallin që u bë Cezar, dhe Julianin që u bë August.

Në vitin 305 Diokleciani abdikoi me dëshirën e tij nga froni dhe e detyroi edhe Agustin tjetër, Maksimianin, që të jepte dorëheqje. Të dy çezarët kishin marrë vazjat e tyre për gra, u bënë agustë, pra Gai Galeri dhe Konstanc Klori, të cilët duhet të caktonin dy çezarë, për të bashkë qeverisur.

Konstanc Klori vdiq në Jorkshir të Anglisë, dhe ushtria e shpalli perandor birin e tij 20-vjeçar, Flav Konstandinin, të cilit Galeri i dha titullin çezar. Nga ana tjetër, një pjesë e ushtrisë e shpalli si Perandor të birin e Maksimianit. Në luftë për pushtet u vra Maksimiani me Galerin.

Mbetet vetëm Diokleciani, i cili e ndihmon Konstandinin. Përfundimisht, Konstandini, i mbështetur nga Valer Licini fitoi kundër Makenit, të cilin e mbytën në lumin Tiber. Kështu Konstandini erdhi në pushtet dhe bashkë-qeverisi me Licinin deri në vitin 324, të cilit i kishte dhënë të motrën për grua. Ndërsa pas këtij viti deri në vitin 337, ai qeveris i vetëm, pasi e detyroi Licinin të hiqte dorë, sepse ai kishte filluar t'i persekutonte të krishterët.

Valesioni thotë se "Konstandini lindi dhe u edukua në Naise (Nish në Dardani-në Ilire), nga nëna e tij Helena, që ishte e një shtrese shumë të ulët, e cila u martua me Konstancë Klorin. Pas kësaj ai u nda nga Helena, pasi u detyrua ta merrte për grua vajzën e Maksimilianit, Teodorën. "

Konstandini qe pak i arsimuar dhe peng te Diokleciani dhe Galeri në kohën e të cilëve ai luftoi me trimëri" .

Konstandini i ndoqi me përpikmëri reformat e Dioklecianit, bashk-atdhetarit të tij, që e ndihmoi për të ardhur në pushtet. Ai e ruajti po atë ndarje administrative, por e kreu edhe një ndarje të re në katër prefektura si të Lindjes, Ilirisë, Italisë dhe Galisë, në krye të të cilave qëndronin prefekt të cilët i nënshtroheshin qeveritarëve të 12 dioqezave dhe të 100 provincave.

Ai nxori ligje të çuditshme për kohën, por që në feudalizëm nuk do të ishin aspak të tilla, pasi do të ishin shtylla të tij. Kështu ai e lidhi koloninë pas tokës, zejtarinë pas zejes dhe nëpunësin pas qytetit, askush nuk kishte të drejtë të largohej nga puna dhe vendi i banimit, ndryshe dënohej me sanksione të rënda.

Ai e shpërnguli kryeqytetin nga Roma në lindje, duke e ngritur një qytet sipas shembëlltyrës së Romës, të cilit i vuri emrin e tij, Konstantinopol, e që është Stambolli i sotëm. Kalimi i kryeqytetit në Konstantinopol, ishte një veprim i zgjuar nga ana e tij, sepse Roma ishte e ekspozuar ndaj sulmeve të huaja dhe ishte e lehtë për t'u pushtuar, ndërsa Konstantinopoli ishte në vend të sigurt dhe i mbrojtur nga natyra. Në fakt, Roma ra nën pushtetin gjerman ë vitin 476, ndërsa Bizanti ose Konstantinopoja ra më 1453, nën sundimin osman. Pra, koha tregoi se sa i zoti dhe i zgjuar kishte qenë fshatari nga Iliria.

Ndaj fesë katolike, Konstandini ndoqi një politikë tepër favorizuese. Kështu me Ediktin e Milanit të vitit 313, e shpalli

lirinë besimit të krishterë në kuadër të mbarë Perandorisë Romake. Ai i dha kristianizmin botës, e që ndoshta pa këtë veprim nuk do ishte kaq e kristianizuar sa

Madh nga historianët, sepse i dha paqe e qetësi vendit, por mbi të gjitha i dha kristianizmit vlerat me të cilat mburret pjesa më e madhe e perëndimit sot.

Ka qenë një strategji e madh ushtarak, që nuk njohu humbje gjatë jetës së tij. Konstandini i Madh nga Nissusi Dardan pati disa fëmijë. Me Minevrën gruan e parë, pati Krispin që e morri titullin e çezarit. Më pas u martua me Faustën, vajzën e Maksimianit, dhe pati pesë fëmijë si Konstandinin e II, Konstancin e II, dhe Konstandinin e I, dhe dy vajzat e tij, Konstandinën dhe Helenën.

Perandoria u nda në tri pjesë, kështu që perandori Konstandini i Ri, i mori tokat përtej Alpeve, Konstanti, e mori Azinë dhe Orientin, ndërsa Konstanci II, e mori Ilirinë, Italinë dhe Afrikën. Gjithashtu, Konstandini u dha nipërve të tij; Dalmatin, Trakinë, Maqedoninë; ndërsa vëllait të tij ia dha Armeninë në qeverisje. Djali i parë i Konstandinit, ishte Krispi që e kishte me gruan e parë. Këtë e ekzekutoi, pasi gruaja e dytë e akuzoi atë për incest (marrëdhënie intime me njerëzit e familjes), por më vonë doli e vërteta që ai ishte, i pafajshëm, dhe për këtë ai e dogji gruan e tij të gjallë me ujë, të valuar, e cila ishte e bija e Maksimianit.

Konstandini me ndihmën e nënës së tij, Helenën arriti ta zbulojë të vërtetën, dhe u pendua për vrasjen e të birit. Ai e nxori një monedhë ku shkruante "djalit tim që e dënova padrejtësisht". *** Në vitin 330 e.s., Mbretëresha Helenë vdes dhe varroset në Mediana të Nassusit, në Fronin e të birit të saj, Shën Kostandit të Madh. Ky vendbanim Ilirio-Dardan, gjendet sot mes Nishit dhe Banjës së Nishit, gjegjësisht Ilixhës së Nishit.



është sot dhe këtë e ka bërë një ilir, ose shqiptarë. "Shqiptarët, e sotëm duhet të jenë krenarë, sepse ishte një shqiptarë që i dha kristianizmin botës së qytetëruar me të cilën ajo mburret sot, fe të cilën ilirët e kishin përqaftuar që në dhjetëvjeçarët e parë pas vdekjes së Krishtit".

Në ditët e fundit para se të vdiste, Konstandini u pagëzua si krishterë. Më 22 maj të vitit 337, vdiq duke ua lënë perandorinë tre djemve të tij. Konstandini mbetet një nga perandorët më të mëdhenj të Romës, për këtë ai e ka marrë titullin i

hyjnor, t'u sigurojmë të krishterëve e gjithë të tjerëve, që të ndjekin lirisht çdo lloj forme besimi që t'u pëlqejë, me qëllim që çdo hyjni që banon në qiej të na ndihmojë ne, e të gjithë ata që janë nën pushtetin tonë".

Konstandini i shtym edhe nga e ama Helena Shejte, u muar me organizimin e kishës në anën materiale dhe doktrinale. Të mos harrojmë organizimin e koncililit të Nikeas, luftën kundër arianizmit e "Besojmë" që recitojmë në çdo rit fetar. Atij i takon fillimi i ndërtimit të Kishës në Lateran, "donacioni i Konstandinit", që hapi rrugën e ndërtimit të katedrales së Shën Pjetrit; ndërtimi i Konstandinopojës e sa vepra të tjera, që në ndonji rast edhe të



kundershtum nga Kisha.

Devocioni ndaj tij është i pranishëm në ambientin shqiptar. Disa kisha mbajnë emnin e tij. Piktoret mesjetare shqiptare pikturuan portrete, ndërsa arbëneshët e përjetsun tuj i dhanë emnin një fshati, që sot quhet Shën Konstandini. Ai vdiq i kthym në kristian n'momentet e fundit t' jetës së tij, më 22 maj 337.

Nji tjetër risi, reflektim i frymëzimeve konstandiniane, është edhe ekspozita e veçantë e hartave e sjell nga anëtarët e shoqatës kulturore "Europa e Re", me seli në Ascoli Piceno (Itali) nën përkujdesjen e zotnive Gianini Grandiozi dhe Mons. A. Masaafresë.

Hartat e paraqituna gjithsej 12,

reflektojnë arritje në fushën e shkencave hartografike t' kohës; arritjet në fushën e shtypshkrimit dhe të artit, meqë përmbajn edhe shumë vizatime. Ata paraqesin etapa t' ndryshme të zhvillimeve historike në Evropën e shekujve 16-17, ku të randësishme janë edhe të dhanat për vendin tonë, të cilat na ndihmojnë të bajm një krahasim hapsinor të trojeve tona, tuj na shërbye në këte mënyrë edhe si kujtes historike. Natyrshëm çdo hartë afron një realitet të ndryshëm nga ai sotmi, i të bamt hartat. Aty mund të vërehen edhe pasaksti të vogla, por asgja nuk pengon perceptimin e drejt. Në ekspozitën që na paraqitet një vend t'randësishëm xanë edhe hartat, siç e njohim në shqiptarët, të Coronelit, (Vincenzo Maria). E ndiejm veten të emocionum teksa shikojmë hartat të tjera të bame prej tij. Punimet e Coronelit (kozmograf i Republikës së Venedikut) e njohim, ashtu siç njohim edhe ato të hartografëve të tjerë të 1500-s, si: Giovanni Gastaldi (1548) dhe Giovanni

Francesco Camozio (1571). Punimet e Coronelit së bashku edhe me arsyetimet hartografike, toponomastike dhe historike etj. janë sjellë vite më parë, në 1933-shin, në botim të veçant me titull: "Vende, kisha , male, lumenj, toponime....." etj. nga një tjetër italian, konsulli Ermano Armao. Kjo vepër është përkthye në shqip nga Akil Spathari , nën përkujdesjen e E.Kamsit në vitin 2006.

Nga Atë Coroneli, si kontribut i mëtejshëm për pasunimin e këtij koleksioni, kena ekspozu njenën prej gjashtë hartave të shtypuna në Venedik në periudhën 1688-1691, në përmasat 60X48, në formatin që në shkencën gjeografike quhet fletë perandorake, të shtypuna në fletë bakri tuj u bazu si piknisje kordinatash gjeografike, meridianin e ishujve Kanarie, 18° i shmangun në perëndim të Grenuicët.

Faleminderit t'tanve, faleminderit edhe famullitarit tonë t'palodhshmit Dom Gjovalin Suka.

NJË DITE ME GJENERATEN E ARDHME TË FAMILJES KAPAJ

Të gjithë e njohim familjen Kapaj nga Toplana. E njohim si një familje të hershme e me shume tradita. E njohim si një familje të re e të emancipuar. E njohim si një familje mikpritëse. Por e njohim edhe si një familje shume punëtore që edhe gurit ia ka rrëmbyer e i rrëmben ato çfarë ka pas dhe e ka të dobishme.

Sot, kjo familje është shpërndarë në disa familje, në celula të vogla. Ka një shtrirje gjeografike nga Toplana, Shkodra deri në Greqi, Itali, Belgjike dhe në SHBA. Me gjithë këtë shtrirje gjeografike një gjë të bien në sy, që është për t’u lavdëruar e përshëndetur se, të gjithë bashkëpunojnë me njeri-tjetrin në gëzime dhe në hidhërime, i udhëheq në jetën e përditshme dashuria në mes njeri-tjetrit dhe ndihma reciproke.

Vitin që shkoje, kjo familje pati një tronditje të rende. Ju ndanë nga jeta 3 pjesëtar: Gjini, djali i Markut e Drandes, bashkëshorti i Rozës e baba i Marselit e i Maries. Ishte biznesmen i njohur. Fatio-ni, djali i Franit dhe i Lezes, studionte në Itali për shkenca politike. Ishte djalë për t’u lavdëruar. Bardhja, bashkëshortja e Dedës dhe nena e Mireles, Mikelit, Fab-janes dhe Manuelit. Ishte amvise shtëpie e zonja. Të gjithë ndien dhimbje. Jeta në këtë familje vazhdoi e vazhdon. Secili diti të mposhte dhimbjen, të gjeje forca e energji të reja për të ecur vetëm përpara. Po, kush ishte themeloria e kësaj force? Themeloria e kësaj force ishte dhe mbetet gjenerata që po rritet në gjirin e kësaj familjeje.

Këto dite Paviora, vajza e Palit e Vjollcës dhe motra e Kristianit festoi datëlindjen. Mbushi 25 vjet. Ftoi në këtë datëlindje të gjithë moshataret e saj, të familjes Kapaj, por edhe ata më të vegjël. Gjithashtu, ftoi prindërit e nënës: Kolen e Linen, tezen Arjana dhe kushërinj: Andi, Alda dhe Tina. Gjithçka ishte e përgatitur më së miri: ushqimi, pijet dhe orkestra.

Dikush e pyeti, aty Pavioeren: Si e ndien veten në këtë moment? Paviora përgjigjet: Jam shume e gëzuar dhe e lumtur jo vetëm se e festoj datëlindjen midis njerëzve të mijë, që i dua e më duan aq shume, por ky moment më forcën bindjen, besimin se unë s’mund ta kuptoj jetën e ta dua atë jashtë dashurisë së madhe që kemi për njeri-tjetrin. Unë jam një shqiptare-amerikane, banoj në SHBA bashke me babin Palin, nënën Vjollcën, vëllain Kristi dhe axhën Lushin. Shkalla e integritetit tone në shoqërinë amerikane është e mire. Unë vijoj arsimin e larte për mjekësi. Kristi vijon të lartën për arkitekture. Mami e babi punojnë; ndërsa unë e Krsiti punojmë nga pak. Gjuhen e kemi përvesuar mire. Kemi marre nenshtetësinë amerikane si familje.

E vërtete se, jetojmë shume larg njerëzve tone, por e them me shume sinqeritet se, mendjen dhe zemrën e kemi tek vendi ynë, tek njerëzit tone. Kujtojmë vendlindjen, kujtojmë dhe përpiqemi të ruajmë traditat e bukura të familjes tone e të shoqërisë shqiptare.

Orkestra vijon të bej punën e saj. Na jep kënge e valle me motive të ndryshme. Kristi lutet drejtuesit te orkestrës të jap këngën e Toplanes. Në momentin që kënga filloi të jepet, Denisi me shume lezet ngrihet nga vendi dhe fton të gjithë të rreshtohen në valle, ndërsa ai me gjithë fuqinë e tij të shpirtit, por dhe melodioze këndon këto vargje: “Moj Toplane, moj Toplane / fshat i vogël por me shume fame / ...”. Të gjithë kënaqen, në fytyrat e tyre shikon atë, që kjo familje ka edukuar dhe vijon të edukoje te të rinjtë e saj dashurinë për vendlindjen, dashurinë për Toplanan, dashurinë për folklorin shume të pasur të zonës e të tjera e të tjera.

Bekimi vijon shkollën e larte për stomatologji në Tirane. Marseli është biznesmen; ndërsa motra e tij, Marinza ka përfunduar studimet për psikologji. Flori,

djali i Mirës, nipi i Kapajve, në muajin gusht u martua me vajzën beratase dhe e urojme: u gëzofshin, u lumturofshin dhe u shumofshin. Ka punuar në Itali me familjet e tij Sokoli, Nika e Gjovalini me familjen e tyre jetojnë e punojnë në Greqi; ndërsa Gega e Sadiku punojnë e jetojnë në Belgjike. Vlerat që i karakterizon ketë brez, ketë gjenerate të re janë shembull frymëzimi për shume të rinj e të reja.

Marashi, djali i Pjetres dhe i Lizës banon ende në fshatin e lindjes, në Toplane. Njeri e pyeti Marashin: Çfarë mund të na thuash për jetën sot në malësi? Marashi, që nga natyra e tij duket i qete, i pëlqen pak vetmia dhe flete pak, por thotë atë që duhet, fillon të përgjigjet: “Ne, që ende jetojmë në malësi, merremi me pak bujqësi e blegtori, me to sigurojmë bukën dhe ushqimin, por pasi rreth 95 % e banoreve e kane braktise ketë fshat, jeta behet ende më e vështire. Mungon infrastruktura, njeriu mund të sëmuret dhe mund të vdesë se, mungon personeli shëndetësor i kualifikuar, s’ka ilaçe. Qendrart shëndetësore në këto zona edhe aty ku janë, janë në gjendje të mjerueshme. Mungon siguria për jetën, kanuni i Lekes, i cili duhet të jete në muze, është ulur këmbëkryq në vatrat tona, gjakmarrja e ngujimi janë bashkudhëtare të jetës, vetmia ka pllakosur të gjithë. E vetmja e gëzimit është e vogla Marinela, vajza e Mirashit, është 5 vjeçe, shikon Tinën, sepse rrok e puth Vjollcën, të cilën e ka teze, i afrohet dhe e shtynë, duke i thënë: Ti, Tine mos guxo me më shty se, Vjollca është e imja. Ky veprim i kësaj vogëlush-eje ka shume kuptim që mund të sintetizohet në faktin e njohur se, ketë familje e përshkon fund e krye ambicia që shprehet në manifestimin e vullnetit e dashurisë për njeri-tjetrin, faktor i rëndësishëm që ndikon në rritjen e gjeneratës së shëndetshme.

Gjenerata e familjes Kapaj, rritja e edukimi i saj është shume me i gjere se sa është thënë më larte. Kush ka kaluar në lagjen Tepe, nuk mund të mos i ketë tërhequr vëmendjen një pjese e shtëpive të kësaj lagjeje. Aty, në afërsi të godinave ushtarake është shtëpia e Markut, Dedes, Pjetres, Marselit, Geges dhe Sadikut, të rrethuara me tarracat e bukura të mbushura me lloje të ndryshme pemësh, me vresht rrushi. Në këtë bukuri është dera e Markut, por edhe projekti i tij. Edhe puna e palodhur e Rozës, Drandes dhe Gjeloshit ka sjelle këtë pune që është për t’u lavdëruar. Deda ka zënë vend këtu, më vone se të tjerët, por shpirti i tij prej një punëtori shembullor ka bere edhe të pamundurën për integrimin e tij në këtë pjese të lagjes. Deda, ketë pune integrimi se ka bere vetëm. Kryesorja e kësaj arritjeje është dhe mbetet frymëzimet e fëmijëve të tij me dashurinë për punën. Po ecën me shume sukses, sepse fëmijët e Dedës: Mirela e Mikeli janë pak më të rritur se të tjerët, krahas shkuarjes në shkolle janë edhe punëtor shume të mire.

Familja e gjeneratës Kapaj, ka qene, është dhe mbetet një frymëzim i madh për të gjithë ata që e njohin atë për rritjen e shëndetshme të brezit të ardhshëm me dashurinë për vendlindjen e tyre, për traditat e bukura, për dashurinë për punën e jetën, për mikpritjen e të tjera e të tjera.

Mendoj se, çdo familje ka për detyrë të kontribuojë shume për rritjen e edukimin e shëndetshme të brezit të ri, të gjeneratës së re në gjirin e saj, si problemi me themelor i kohës. Kjo arrihet jo lehte, dhe që të arrihet ky objektiv kërkohet që çdo familje të ketë konceptin të drejte se, çfarë është gjenerata, domosdoshmëria e edukimit e rritjes së shëndetshme të saj, rrugët e mjetet që duhen përdore në lufte të papajtueshme me të gjitha ato që jo në pak raste vijnë nga një mentalitet primitiv, të cilat janë dhe mbeten pengese objektive për arritjen e emancipimit madhore në këtë drejtim.

KOLE FUNIÇI

Një emër, në kujtim të vendlindjes!

-Skicë-

Profesor Ahmet Osja, vite më parë me një tufë lule do nderonte në një pritje mikeshën e largët. Atë ditë, në përvjetorin e shkrimtarit te madh Martin Camaj, profesor Ahmeti tek po i dhuronte lulet zonjës i tha: Martin Camaj, tashmë spikat si një shkrimtar i madh ne fondin e letrave shqipe, kjo është thënë, vlerat e tij po zënë vendin që meritojnë. Janë shumë vepra që e lartësojnë figurën e tij, kjo na bën krenar të gjithëve. Tek Camaj, spikat dashuria, ai gjithnjë do kujtonte atdheun, vendlindjen e tij me shkrime e personazhe me gjuhen, e të tjera, e të tjera.

A dini ju zonja Erika se: - Martin Camaj ndoshta përveç dashurisë që ka pasur për ju, ka dhe një arsye tjetër që djaloshi nga Temali i Dukagjinit ju zgjodhi, JU për bashkëshorte!? Është emri juaj “Eric (k)a” disi i veçantë, por i njëjtë me e emrin e një bime përherë të gjelbër, me lule të bardha,

lajmëtare e parë e pranverës, me shumë aromë, një bimë e dashur nga bleta, me dru mjaft të përdorshëm, bëhet fjalë për bimën shqopës. Eric(k) a arborea, është emri latinisht i saj, shtoi profesor. Erika Camaj, tashme jo vetëm gjermane, por dhe një shqiptare e nderuar, bashkëshorte e të madhit Martin Camaj, u mrekullua nga ky fakt nga emri kësaj bime që rritej në vendlindjen e bashkëshortit të sajë të dashur. Kjo, një lidhje tjetër me natyrën shqiptare me Shqipërinë.

Ndoshta, shkrimtari i madh atje larg vendlindjes me mall për të, tek shkruante pareshtur, sa herë thërriste emrin e bashkëshortes - Erika, kujtonte vendlindjen e tij, Erika, pas kësaj që i tha profesor Ahmeti, ka dhe më shumë dashuri për atdheun e bashkëshortit, për natyrën shqiptare, për bimët e saj, ku njërës prej tyre i ka marrë dhe emrin.

Gjon Fierza



At' Bernardin Palaj, filolog, filozof dhe muzikant!

Atë Bernardin Palaj ka kenë, poet, mitolog, studiues, shkrimtar, filozof dhe pianist, një studjues dhe muzikant me të ardhme shumë të madhe. E ardhmja e tij muzikore ishte e lidhur edhe me formimin e tij shpirtnor dhe intelektual.

Ai ishte një njeri me kulturë të gjanë që dallohet qartë në të gjithë punët e tija intelektuale.

Edhe në fushën muzikës ai, kmpozoi pjesë të ndryshme muzikore të mbështetuna në traditën shqiptare mbi modet dhe meloditë e pastra tona tradicionale. Palaj vlerësonte maksimalisht kulturën tonë nacionale dhe mbi këtë fenomen mbështetej i gjithë arti i tij në përgjithësi.

Një prej këtyre pjesëve të vogla muzikore, të cilën e kam luajtur është edhe **“Kanga e “Flamurit”**. Kjo pjesë asht një kangë e vogël e cila i kushtohet **“Flamurit të Arbërit”**. At' Bernardin Palaj i ka shkruar me shumë dashuri flamurit tonë.

Ajo asht një kangë e thjeshtë, me një melodi shqiptare që ngre lart vlerat e “Flamurit nacional”, simbolit ma të çmuar për nacionalitetit tonë.

Kanga asht kompozuar për “Bujri” në Si bemol (Trombë) dhe Kangë (Soprano).

Ajo asht konceptuar në formën e një marshi me karakter epiko-lirik, elementë të cilët i japin melodisë një vend shumë të randësishëm. Melodia e thjeshtë dhe shumë komunikative jep një mesazh të madh për flamurin tonë.

Harmonia asht klasike, e thjeshtë dhe asht e mbështetur mbi motivet tradicionale shqiptare. Palaj e ka shkruar hymnin për za që asht pjesë e psikikës njerëzore dhe një element i randësishëm i saj, gjithashtu për Bujri, veglat e frymës të cilat transmetojnë edhe këto shumë emocione shpirtnore.

Kënga e flamurit luhet në Unison, këngëtarja dhe Bujria (tromba).

Unisoni ka një vlerë të madhe dhe

shpreh unifikimin e mendimit, tingullit dhe frekuencave, shpeshhtësisë të tij.

Në fillim, fillon instrumenti i Trombës



(Bujria) me disa sinjale kushtruese dhe pastaj ajo luhet në unison, tromba me kangëtarën.

Në pjesën, kur lot Tromba dhe kangëtarja, kompozitori i ka unifikuar me një “Legato” të madhe. Tromba dhe kangëtarja duhet të lozin me legato që lidh mendimin e kangëtares dhe instrumentistit. Në fund kemi disa sinjale trombetistike të cilat janë përdorur për ta mbyllur kangën.

Atë Palaj ka arritur me mjeshtëri të unifikojë tingullin e (Bujrisë) trombës me kangëtarën.

Në fakt kemi të bajmë me një kangë, hymn, e cila jep një mesazh të madh duke lartësuar Flamurin tonë, i pari në zonën e Adries, Adriatikut, siç shkruan kompozitori në tekst.

Gjithashtu, teksti kangës i shkruar në

gegërisht, transmeton me fjalë krahas muzikës një mesazh shumë të randësishm për nacionalitetin shqiptar dhe flamurin tonë kuq e zi. Palaj, shkruan shumë qartë dhe me vertetësi kur e konsideron nacionalitetin tonë si të parin truell në Ballkan. Edhe melodia asht tipike shqiptare.

Autori shkruen: **“Ti kuq e zi valvite ç’së kombi ilirjan / N’breg të Adries nu m’i ditë ma t’ parin truell n’Ballkan”**.

“Kangën e Flamurit” të Atë Bernardin Palaj e kam luejt në ditën e pavarësisë, para disa vitesh në “Kinema Milenium” në Shkodër, me mexosopranon Rita Der-vishi. Loja trombë soprano, tigëlloi shumë interesante. Në fakt pjesa krahas vlerave muzikore të mirëfillta asht edhe një pjesë antikuare që tregon formimin e lartë intelektual dhe shpirtënore të Palajt.

Asht interesant fakti se kompozitori ka ditë që nëpërmjet një materiali të vogël të japi shumë informacion muzikor dhe intelektual.

Kanga asht e konceptuar në Unison me instrumentin i Trombës dhe kangëtarën ka vlera qytetare dhe muzikore.

Kjo kangë asht një melodi e thjeshtë me një mesazh shumë të randësishëm për kohën dhe ajo ka edhe vlera aktuale.

At’ Palaj dhe brezi me të cilin ai punoi patën vlera të mëdha intelektuale dhe qytetare.

Por, diktatura më e ashpër në vendet e ish-lindjes, jo vetëm që nuk i la me shpreh talentin e tyre, por i burgosi dhe i vrau në burgjet e tij.

At’ Bernardin Palaj kishte lindur në vitin 1896 në fshatin Shllak të Dukagjinit dhe pasi kishte marrë mësimet e para në Kolegjin Franceskan të qytetit të Shkodrës, ishte diplomuar për Teologji në Innsbruk të Austrisë. Kultura austriake ndikoi në formimi e tij të matejshëm.

Pas mbarimit të Studimeve ai, u kthye në vendlindjen e tij ku u caktua profesor i Historisë dhe Latinishtes në Liceun “Il-

Më 13 shtator 1986, ndërsa bëheshin qitje në poligonin e regjimentit të Farkës, ushtari elbasanas Fatmir Skilja , i shushatur, nuk e vërviti granadën luftarake, por e lëshoi pranë, para këmbëve të tija dhe ajo, tanimë pa fitil, po rrokollisej drejt grupit më ushtarë, mes të cilëve ndodhej dhe një luan.

Ky luan ishte piloti Ndue Logu që u hodh me trupin e tij mbi 100 kg e mbi 180 cm i gjate; që u hodh planzhon drejt vdekjes së tij të sigurtë për të bllokuar djallin e zjarrtë që kushedi se sa jëtë ushtarësh do të merrte pas atyre fare pak sekondave që i kishin mbetur pa vjellë tër masën e tmerrëshme të vdekjes, që kishte ngërthyer në grushtn me llokma të metalta.

Granata plasi në barkun e heroit nga Shoshi i Dukagjinit dhe rritur në shtëpinë e fëmijës, por duke shpëtuar gjithëcka tjetër përqark.

Ishte një akt vetmohimi jo i paparë në

liricum” dhe krahas asaj pune, për afro 20 vjet me rradhë u morr me mbledhjen e “Eposit të Kreshnikëve” të Veriut të Shqipërisë, si dhe me doket e zakonet e atyne krahinave. Studjues te huej e kanë vlerësue shumë punën dhe veprën e Palajt, si mitolog dhe mbledhës folklori. Prejardhja e tij nga malet dhe studimi për vlerat e maleve dhe folklorit tonë i dhanë frymëzimin At’ Bernardin Palajt me shk-rue me shumë dashni për këto tema jo vetëm letërsi por edhe muzikë nacionale. Studiues të huej e kanë vlerësuar shumë punën e Atë Bernardin Palajt!

Albanologia e shquar ruse, Desnickaja e quan **“Njohësin ma të shquar”** të Maleve tona. Ai ishte muzikant dhe pianist i shquar. Së bashku me At’ Donat Kurtin botuan vëllimin: Kangë kreshnikësh dhe Legjenda (1939). Ai është autor edhe i shumë punimeve dhe poezive ilirike tjera, të botuara kryesisht në **“Hyllin e Dritës”**: **Prej burgut të jetës (1933), Valët e një shpirti (1934), Varreve të flamurit (1947), Kuq e zi (1937), Kanuni i maleve (1944) e të tjera**. At’ Bernardini, si shpërblim i punës së kryer, arrestohet në vitin 1946. Vuajti torturat ma ç’njerëzore. E lidhen me tel të ndryshkun me javë të tana, deri sa iu helmua gjaku dhe vdiq nga tetanosi. Sot nuk iu dihet varri.

Po citoj edhe disa vargje të një poeme të Palajt për flamurin. Dashuria për flamurin tonë kuq e zi duket qartë edhe në këto vargje. Autori me respekt të thellë për simbolin tonë kuq e zi, ka lanë nëpërmes vargjesh të thjeshta, por plot pathos një mesazh për të gjithë neve, që ta respektojmë dhe ta duam flamurin tone, të nacionalitetit tonë. Ashtu si me muzikë edhe në këto vargje nëpërmjet forcës së fjalës, Palaj i këndon flamurit tone, i cili përfaqëson të gjithë historinë tonë shumë të lashtë. Ai shkruen tek poema **Vorreve të flamurit: “Eni moj Zànapra, e Shtojzovalle / E rreth Flamurit t’onë sot kndon valle, / Aso vallesh piri-rike, si knduet motit / Para Lekës e Burrit, Teutës e Kastrijotit!”**

At’ Bernardin Palaj ka kenë një meshtar dhe artist me vlera të larta intelektuale dhe artistike.

Qamil Gjyrezi, pedagog në Universitetin “Luigj Gurakuqi”

PLANZHON MBI GRANADËN PA FITIL

NGA RIZA LAHI

(Në pervjetorin e renjes në krye të detyres të pilotit,burrit dhe trimit të maleve të Dukagjinit “Deshmorit te kombit”, NDUE MEHILL LOGU, zgjedha per botim kete shkrim te Riza Lahit.

Lavdi në shekuje shqiponjes së ajrit, Mic Sokolit që mbuloje me vdekjen granaten. Vdiq per të shpetuar jete, vdiq per të mbetur në altarin e pa vdeksisë.

Populli i kendon ketije gjigandi: “Kalojn jave muaje edhe vite / Emri i Ndues sa vjen dhe rritet / Sa here vjen 13 shtatori / lule të freskta të bien tek vorri / që nga Brashta ku ti linde / nga Vermoshi në Konispol / si shqiponje ti fluturove /ç’do detyre me nder mbarove.

Gjin Musa)

historitë e ndeshjeve me eksplozivët; ne njohim rastet e Mic Sokolit nga Malësia e Gjakovës, Selam Musait nga Salaria e Vlorës, Aleksandër Matrazov nga Moska dhe ... ja dhe rasti i pilotit më të mirë që kishte regjimenti i Farkës, atij burri vetulzi, ballëpastër, që ecte duke buzëqeshur me vete dhe me një ecje prej balerini, kryemjeshtër i njohjes së territorit, instruktorit fluturues të disa breza pilotësh, Ndue Logut nga Dukagjini.

Ndue Logu mundi ta merrte diplomën me rezultatet më të larta që mund të jepte një shkollë ushtarake në Bashkimin Sovjetik; mundi ta merrte në Batajsk – si pilot helikopteri, por edhe ai, në vitin skandaloz 1961 u kthye në atdhe së bashku me 18 pilotë të tjerë, pavarësisht se dy prej këtyre djemve qenë thyer.

Ti djalosh që lexon tani “Dinosaurët e fundit” duhet të dish se burrnia është vënë në provë në të gjithë brezat që kanë formuar karakterin shqiptar.

Koloneli i Shoqatës “Atdhetare-Dukagjini”, Ndue Sanaj nderohet me kater “grada”

1. FALEMINDERIT KRYETAR; 2. NDERI I ALEANCËS KOMBËTARE TË USHTARAKËEVE TË SHQIPËRISË; 3. QYTETAR NDERI I KOMUNES PULT; 4. MIRËNJOHJA E QYTETIT SHKODËR

Muaji shtator i këtij viti ishte imbushur me shumë aktivitete për shoqatën “Atdhetare Dukagjini”. “Koloneli” i saj, Ndue Sanaj kishte planifikuar shumë gjëra, por nuk e kishte menduar se do t'i shtonte tri “gradat” më të çmuara të karrieres së tij shumëvjeçare. Por, nderimi i veçnatë për Ndue Sanaj, në cilësinë e Kryetarit të Shoqatës “Atdhetare-Dukagjini”, filloi atëherë, kur kjo shoqatë festoi 10 vjetorin e themelimit të saj, në të cilën bashkëpunetoret e bashkëpunetorët e nderuan duke i dhënë portretin e tij me mbishkrimin: “Faleminderit Kryetar!” me të cilin i sollën shumë emocione të papershkrura.

Kryetarit të shoqatës “Atdhetare-Dukagjini”, Ndue Sanaj, në kuadër të 70 vjetorit të lindjes së tij, koleget e tij, të kuadruar në Shoqatën “Aleanca Kombëtare e Ushtarakëve të Shqipërisë”, me datën 1 shtator 2013, jo vetëm që i festojnë këtë përvjetor të lindjes, por dhe i japin edhe titullin e lartë “NDERI” i kësaj Shoqaate, të cilën ja dorezon shoku i shkolles, Nen kryetari i saj, Bajram Mane., me motivacion: “Per kontribut të shquar në përgatitjen ushtarake dhe gatishmetrine luftarake të Ushtrisë Shqiptare, si aktivist i dalluar për organizimin dhe

“Mirënjohja e qytetit Shkodër”, me motivacion: “Per kontributin e dhënë si intelektual i shquar dhe aktivist i shoqërisë civile në krijimin dhe drejtimin e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”.

Pas shumë vitesh pune në profesio-

-Ne, si përfaqësues të komunës Pult, në mes të tjerave theksoi kryetari i kësaj komune, Sokol Cubi, - jemi krenarë që Ndue Sanaj është bir i kësaj zone, ju falenderoj që u bëtë pjesë e këtij aktiviteti për të respektuar dhe vler-

e Shefit të Shtabit të Divizionit të Këmbësorisë në Shkodër, me gradën kolonel, në muajin maj 2001.

Dashuria për vendlinjen, pasionin dhe dëshirën për t'u vënë në shërbim të shoqërisë prevojën e tij si drejtues ndër vite e nxitën atë që në vitin 2003 të ishte nismëtar për krijimin e shoqatës “Atdhetare-Dukagjini”.

Puna e tij dhe e kolegëve të tij padyshim ka bërë që vlerat historike, kulturore dhe tradicionale të Dukagjinit të evidentohen, të pasqyrohen dhe të dokumentohen në mënyrën më të mirë të mundshme. Në si komune jemi përpjekur që t'i mbështesim në punën e tyre vullnetare, por me mjaft vlera për komunitetin tonë dhe për brezat e ardhshëm.

Padyshim që vlerat e Ndue Sanaj si drejtues, organizator dhe lider i kësaj shoqate kanë lënë mbresa tek gjithë opinioni qytetarë dhe intelektual i Shkodrës. Prandaj, këshilli i Komunës Pult në kuadër të 70 vjetorit të datëlindjes së tij, duke i uruar Ndues jetë të gjatë, ka menduar ta vlersojë atë për punën e tij të palodhur në angazhimin, përkushtimin dhe rezultatet e tij në drejtimin e shoqatës “Atdhetare-Dukagjini”, kanë qënë dhe do të mbeten një shembull nxitje për të gjithë ne”.



nin dhe karrierën e tij ushtarake, për 10 vite në drejtimin e kësaj shoqate ai, ka

suar njërin nga intelektualët dhe më të njohur të Dukagjinit Ndue Sanaj.



funkcionimin e Shoqatës Aleanca Kombëtare e Ushtarakëve të Shqipërisë-dega Shkodër”.

Në këtë kuadër, nderohet nga Këshilli i komunes së Pult me titullin e lartë “Qytetar Nderi i Komunës Pult”, me motivacion: “Për kontributin e tij në ruajtjen dhe promovimin e vlerave historike, kulturore e tradicionale të komunes tone dhe të gjithë zones së Dukagjinit”.

Po, në këtë kuadër edhe Këshilli i Bashkisë Shkodër, e nderon me titullin

fituar një provojë të re, por ka fituar edhe admirimin, mirnjohjen dhe vlersimin e shumë njerzve dhe institucioneve.

Në ambjentin e hotel “Meteor”, komuna Pult ka organizuar një ceremoni të veçantë, me përfaqësues të kësaj komune, antare dhe aktiviste të shoqatës “Atdhetare-Dukagjini”, me kolege të tij ushtarake në rezerve dhe në pension të kuadruar në “AKUSH”, miq dhe familjarë të Ndue Sanajt, ishin mbledhur në një ceremoni mjaft të larmishme.

“Ai, ka lindur me 1 Shtator të vitit 1943 në fshatin Gjuraj, komuna Pult e krahinës së Dukagjinit. Ka përfunduar shkollën e mesme të përgjithshme “Skënderbej” në Tiranë. Në vitet 1962-64 ka përfunduar studimet për oficer. Gjatë periudhës 1968-1970 ka përfunduar studimet e larta ushtarake pranë Akademisë së Shtabit të Përgjithshëm.

Ndue Sanaj ka punur për shumë vite në organet drejtuese të ushtrisë dhe e ka mbyllur karrierën e tij në detyrën

Në emër të këshillit të Komunës Pult, kryetari i këshillit të komunës, Gjin Brigja i ka dorëzuar titullin “Qytetar nderi i Komunës Pult”. Aktiviteti ka vazhduar pastaj në ambjentet e jashtme me një koktej për të pranishmit, organizuar nga komuna Pult.

Shumë foto dhe kujtime, shumë intervista dhe falenderime nga të pranishmit kanë qënë rituali i kësaj dite që do mbetet një kujtim i vecantë për ne, por veçanarisht për zt. Ndue Sanaj.

Agron Luka

Rozafati e Migjeni ...

(ESE, MEMUARISTIKË, KRITIKË LETRARE E HISTORIKE, RETROSPEKTIVË E PERSPEKTIVË)

1. “Legjenda e Rozafatit”, simbas interpretimeve të Dh. S. Shuteriqit (1947-1977)
2. Diskutimi kritik e bibliografik i Gjovalin Lukës, “Rreth varjanteve shqiptare të Legjendës së Rozafatit dhe mbi interpretimin e tyre” (1949-1950)
3. Si degjeneroi “filli illyrian-migjenian i folesë së shqiponjës”, si “foleja e Enverit në themelimin e PKSH në Tiranë”...

(Botohet i shkurtuar)

Midis disa dorëshkrimeve e daktilografimeve të babait tim, në të cilat ruhen Kritika letrare e botuar në shtypin e asaj kohe, ndaj romanit “Çlirimtarët”, kam gjetur edhe një letër dy faqoshe të daktilografuara, të vitit 1950, drejtuar Dh. S. Shuteriqit. Kjo letër paraqitet si një material për diskutim, si bibliografi e kritikë. Për fatin e keq, duke e gjetur shumë kohë mbas vdekjes së Gjovalinit, nuk kam dijeni, nëse ky diskutim mund të ishte zhvilluar apo jo në L. SH. SH. Mendoj se, fillimisht duhet t’i ishte dërguar para-prakisht Shuteriqit, për konsultim. Një ndihmë konkrete duhet t’i ketë dhënë prof. I. Zamputi, prof. A. Buda, vëllai i tij Kol Luka e te tjere. Ajo që duhet shënuar këtu është

se, pjesa dërrmuese e atyre literaturave që citohen janë ruajtur në original, parvësisht se, koha disa i ka dëmtuar. Ndër peripecitë, internimet e vuajtjet e gjata që kaloi familia e jonë, në vartësi edhe se ku ishin shpërndarë librat e bibliotekës së babait, pastaj edhe të kontrolleve e tyrli shkaqesh shkatërrimtare, disa nga librat e koleksionet e babait humbën e disa shpëtuan.

Po e botoj këtë letër:

17/XII/1950

Shoku Dh. S. Shuteriqi,

Urime për botimin e vëllimit të ri poetik dhe ju falënderoj për kopjen me firmën tuej. Mbi sa më keni propozue me shkruie një artikull për kritikën letrare, jam dakort.

Tuj përfitue edhe nga rasti, dishroj t’ju rikujtoj se në L. SH. SH. e kemi lanë të hapun zhvillimin e një diskutimi mbi interpretimet dhe varjantet shqiptare të

Legjendës së Rozafatit. Materiali që kam nxjerrë deri më tash asht si ma poshtë:

1) M. Barleti, “Rrethimi i Shkodrës”, Venecia 1504. Autori shkodran i shekullit XV jep informacione mbi historinë, ndërtimet, rindërtimet, mirëmbajtjet e restaurimet e qytetit në kohë të ndryshme; tregon për muret rrethuese e fortifikuese të pjesës poshtë në fushë dhe sipër në

kështjellë. Barleti dëshmon me shkrim se, personalisht ka pasun në dorë e i ka lexue “disa fragmente analesh” të shkrueme me “vernacula lingua scriptum est”. Ishte shkruie aty, tue iu referue memories së të vjetërve tonë se, dy motra mbretnesha të quajtura Roza dhe Fa, mbareshin si “themelueset e para të Shkodrës/primos fundatores urbis Scodra fuisse”. Mendimi i vet Barletit asht se, fragment analet duhen interpretue si një rast rindërtimi-institutionem dhe jo si themelimi i lashtë zanafillues (shprehimisht: “qua in-

stitutionem potius urbis buius, qua aedificationem”). Edhe nënvizimi në anën e faqes përkatëse e shkruen: “Instauratores Scodra”. Në lidhje me mendimet e disa të huejve dhe të vetë turqve muhamedanë se, Shkodrën – Skanderien e ka themelue Aleksandri i Madh, teza e Barletit dhe e disa bashkëkohësve asht: “Shkodra ka ekzistue shumë kohë ma përpara se sa të lindte Aleksandri i Madh”. Këto kumtime dhe shënime i ka nxjerrë dhe mi ka sjellë prof. I. Zamputi, simbas një ribotimi latinisht të librit original të M. Barletit, që gjëndet në Shkodër.¹

2) Më 1215, krahas “Qytetit Skadar, kemi edhe përmendjen e emërtimit të qytetezës e akropolit në formën Rosaf”, në një kronikë-biografi të dinastisë Nemanja. (L. von Thalloczy, “Illyrish – Albanische Forschungen”, 1, Band, München und Leipzig, 1916, fq. 104-107)

3) Dokument – “Raport” nga Shkodra i shekullit XVIII, i gjetun në materialet e pa botueme të Farlatit, origjinali ndodhet në Bibliotekën e Seminarit të Padovas. (Bot. në rev. LEKA, Nr. 10, Tetuer 1932, fq. 314-317) Këtu konfirmohet e vërtetohet tradita e praktika popullore mbi përdorimin e një qumështi/tamblit gëlqeror, “si kurë shërimi për nuset e gratë që nuk iu vinte gjini ose që kishin sëmundje në gjinjt/mamelle”. Shkruhet edhe për një ish vend kult të rrjedhjes së tamblit të gjiut, shoqnue me therje e sakrifikime shtazësh, ku ceremonia e riti nderohej “me veneracion të veçantë, ashtu siç edhe tre shekuj ma parë”.

4) Tregim në prozë mbi një Kangë popullore shkodrane, ku flijohet motra Fata, ku djali trashigimtar Fatbardhë ushqehet me gjinin e nanës që ende kullon. Këtë dëshmi e ka shkruie konsulli francez në Shkodër, H. Hecquard në librin, “Histoire et description de la haute Albanie ou Guegarie”, Paris 1858.

5) Studim dhe botim i pesë nga dhjetë varjante shqiptare, të mbledhuna nga historiani e folkloristi autoritet M. Sirdani. Studimi themelor titullohet “Legjenda e Kështjellit Rozafat”. (“Hylli i Dritës”, Nr. 10, 1930, fq. 541-560) Simbas Sirdanit, në legjendën shkodrane, krahas flijimit njerëzor, theksohet “fenomeni

stalaktit” i piklimit, rigimit e cirkimit të tamblit gëlqeror, sepse i tillë asht i gjith formacioni shkambor aty. Sirdani mbron tezën se, sllavojugorët serbë-malazezë e maqedonas me rastin e dyndjeve dhe okupacioneve, duke përdorë si pretekst edhe ndonji rindërtim-meremetim në Shkodër, përshtatën e kopjuan legjendën e moçme iliro-epirote, tue tentue me sigurue edhe përvehtësimin e pronësisë, ashtu siç kishin veprue me plot raste falsifikimesh historike. Siradani iu kundërvu falsifikimeve, shpifieve dhe orekseve nacionaliste e shoviniste të ish kryeministrit famëkeq sërb Vladan Xhorxheviç.

6) Polemikë e E. Koliqit, “Përgjigje një studiuesi sërb”, botue te revista Shkëndija, Nr. 3, Shtator 1940, fq. 3-9, ku kundërshton e debaton me analizat e konkluzionet e studiuesit sërb S. Stefanoviç, rreth çështjes së origjinës etnike të Shën Gjon Vladimirit dhe mbi varjantin sllavojugor “Ndërtimi i Shkodrës”. Ndërkaq, vetë Koliqi ka rrëshkitë në pozitat e prepotencës së Imperos fashiste.

7) Studim i G. Stadmüller, ku ka shprehë tezën se, Legjenda e Shkodrës me flijim – murim njerëzor, duhet të mbahehet si epiqendër e varjant-legjendave të mavonshme ballkanike. (Përkthimi shqip asht botue në Hylli i Dritës) Autori gjerman midis trajtimeve e argumentimeve multidisiplinore citon Arrianin: “Illirët, siç edhe thrakasit, ende në kohën e Aleksandrit të Madh, praktikonin flijime njerëzore, në raste ndërtimesh, para ndonjë beteje etj”. Për helenët e maqedonët e asaj kohe, këto flijime konsideroheshin tradita e zakone barbare.

8) Ka sinjalizime për ekzistencën e mbledhjen e gjurmëve të disa varjanteve edhe në treva të tjera shqiptare. Më informojnë se në repertorin e muzikës popullore shkodrane, me tekst të marrë nga folklori, ka hy edhe Kanga e Kalasë.

Shoku Shuteriqi, mbi sa sipërshënova dhe mbi vërejtje e kontribute të historianëve e folkloristëve specialistë, lidhun konkretisht me botimin dhe disa nga interpretimet tuaja në “Folklori Shqipe”, 1949, mendoj që Diskutimi të zhvillohet.

Ju përshëndes me respekt

Gjovalin Luka

Mes tjerash ai tha: “Kam marrë shumë vlersime e tituj gjatë jetës time civile dhe ushtarake, kam arritur shumë suksese, kam kaluar edhe momente të vështira, por emocionet më të veçanta po i përjetoj sot, kur vlersohem, respektohem nga njerëzit e mi, nga vendlinja ime ... Ju jam shume mirenjohes!”.

Puna e shoqatës “Atdhetare-Dukagjini” për 10 vite në qytetin e Shkodrës padyshim që ka lënë gjurmë dhe shije të vecanta tek strukturat drejtuese vendore dhe tek shumë intelektualë dhe qytetarë. Një punë e palodhur vullnetate dhe disavjeçare duke evidentuar, promovuar dhe dokumentuar vlerat më të mira tradicionale.

Shumë aktivite e promovime ndër vite, shumë pasion dhe përkushtim, shumë korrektksi dhe profesionalizëm si një lider i vërtet, e kanë bërë z.Ndue Sanaj njërin ndër aktivistët më të shquar të shoqërisë civile në qytetin tonë.

Për këto vlera të veçanta Këshilli i Bashkisë Shkodër e ka vlersuat z. Ndue

Sanaj me titullin. “Mirnjohje e qytetit Shkodër”.

Në ambjetet e bibilotekës “Mrin Barleti” të qytetit tonë në një ceremoni të veçantë te organizuar nga kryesia e Shoqates, me daten 21 shtator 2013, këtë titull i’a dorzoj Kryetari i Keshillit të Bashkise Shkoder, av. Bardhyl Lohja.

Zt. Lohja shprehi konsideratat më të larta për punën e shoqatës “Atdhetare-Dukagjini” në qytetin e Shkodrës duke e konsideruar atë një vlerë për jetën kulturore, artistike dhe shoqërore të këtij qyteti . Sekertari i shoqatës “Atdhetare-Dukagjini”, Luigj Shyti, pasi bëri një paraqitje të punës disavjeçare të zt. Sanaj në drejtimin e kësaj shoqate, në rolin e moderatorit të veprimtarisë komentoi për të pranishmit një dokumentar të prëgaditur enkas për këtë rast. Në ato pak minuta të tij zt, Aleks Dushi kishte përmbledhur aspekte nga puna dhe aktivitetet kryesore të shoqatës ndër vite ku padyshim protagonistin kryesor ka qënë kryetari i saj. Mes shumë pjesmarrsve

në këtë veprimtari në emër të shoqatës “Atdhetare-Dukagjini” përshëndeti Nënkrjetari i saj zt. Gjergj Liqejza. Pastaj përshëndetën ne emer te ushtarakeve ne lirim e ne pension, Dede Zhivani; Mhill Pali nga shoqata “Spani” dhe dramaturgu, shkrimtari Anetari i nderit i kesaj shoqate, Mjeshtri, Fadil Kraja.

Një vlërsim më se i merituar, për vlerat dhe kontributet që mbart ky njeri, atdhetar, patriot, ushtarak i denjë, organizator i veçantë, shok dhe familjarë shembullorë. I i papërtuar në cdo detyrë ushtarake e shoqëore, profesionist i shkëlqyer.

Por po kaq dhe akoma më i përkushtuar dhe më i denjë gjatë kohës së daljes në pension, me një aktivitet të dëndur në krye të Shoqatës «Atdhetare-Dukagjini», gjë që tregon dhe flet se ky njeri nuk njuh moshë. Jeta e tij është në shërbim të atdheut, popullit, familjes, njerëzeve, në shërbim të edukimit të brezit të ri, me ndjenjën patriotike dhe atdhetare. Ky ishte thelbi i të gjitha disku-

timeve që u bënë në këtë ceremoni mjaft domethënëse për të gjithë komunitetin Dukagjinas.

Duke vlersuar zt. Ndue Sanaj është vleërsuar shoqata “Atdhetare-Dukagjini”, të gjithë bashkpuntorët e tij, jane vlersaur tarditat, kultura dhe energjite pozitive që ky komunitet ka sjellë në jetën e qytetit tonë. Unë, presonalisht e shpreh edhe në sallë, po e theksoj edhe në këtë artikull se, organet e pushtetit vendor në Shkodër, intelektualet e këtij qyteti i janë borzhli këtij komuniteti, sepse si në të shkuaren e largët dhe të afërt ashtu edhe sot ne i kemi dhene vlera dhe lavdi historise së këtij qyteti që jo gjithmonë na ka mirpritur. Thirrja dhe apeli im vlen edhe për shumë shokë, miq dhe kolegë të mi që të bashkohemi më tepër për të komtribuar për ato vlera dhe cilsit të përbashkta që i keni. Le të shërbejë ky vlersim që i’u bë zt. Ndue Sanaj, si një motiv më tepër për tu angazhuar të gjithë për integrimin tonë të përbashkët .

Prëgatiti, Lulash Brigja

Me këngëtarin Pëllumb Vrinca

Pëllumb, para se gjithash ju faleminderit që ju përgjigjet ftesës!

Faleminderit juve, është nder dhe kënaqësi, të behëm objekt i gazetës “Dukagjini”! ...

Si po ju ecën karriera dhe si ju shkoj sezoni veror?

Mire, krejt mire, fal atyre që më duan, çdo gjë është perfekt. E, persa i përket sezonit veror, ka kenë një sezon i fort. Në mënyre të veçantë me dasma. Shume pune, pak gjumë, pushime nuk bahet fjale. Por edhe një kënaqësi shumë e madhe, pasi ambientet familjare të dhuroj një ngrohtësi fantastike. Për Ata, që martohen është dita ma e veçantë e tyre, dhe të jesh i zgjedhuri i ditës ma të veçantë të jetës, është një nder, kënaqësi, por edhe përgjegjësi shumë e madhe.

Pëllumb, ku jeni ma shume të përqendruar në pune, në Shkodër apo edhe ma gjere?

Normalisht, në Shkodër, në Veri në përgjithësi, por edhe në Gjakove, në Prishtine e në të gjithë Kosoven, Maqedonin si dhe Malin e Zi, në veçanti në Plav, Guci e të tjera krahina të Shqiptarise. Me pak fjale, kudo që ka shqiptar ane e mban botes.

Tani që po afrohen festat, Ju gjithmon vini me kenge të reja. Po, ketë vit do kemi ndonjë surprize?

Patjeter, siç ju thashe çdo gjë po shkon mire, fal atyre që më duan. Përgjegjesija eshte edhe ma e madhe, kur njerzit të duan që t’jua shperblesh Me pune, me

kenge të reja që i presin me kenaqesi. Aktualisht jame në pune e siper, per kenget e reja që do të jene gati per vit të Ri.

Kjo, do të thote, pushoni shume pak?

Po, është e vertete. Në momentin që mbaron stina e Veres duhet të filloje per-gatitja per stinen e Dimerit. Per kenget e

ju mungon Italia?

Po, kam jetuar atje ku jam edhe rezident. Jam rezident në Firenze. Kam jetuar edhe në Venezia 4 vite. Kam shume kujtime të mira Kam kaluar nje pjese të jetës atje dhe patjeter më mungon, por edhe shkoj. Kur kam pak kohe shkoj atje se, atje kam edhe vellezerit me familjedhe shume të aferm. Puna, qe kam ketu nuk më lejon që të rri shume atje. Atje, në Itali shkoj me pushime, të pakten tre here në vit. Kur shkoje, kenaqem shume se, kam shume miq e shok si Italian edhe shqiptar e të tjere te huaj

Të flasim pak per kenget tuaja, ose më



reja, per koncertet e fund vitit, që jane të shumta në Shqiperi dhe në diaspor. Kjo më pelqen se, nuk ka monotoni. Pra, jena gjithmone në aktivitet dhe kjo ka shume rendesi.

Ju keni jetuar per shume kohe në Itali,

sakt per hitet tuaja. Ku qëndron çelësi i suksesit tuaj, që këngët tuaja janë shume të dashura për publikun?

Ah po! Unë, gjithmonë i kam pëlqyer këngët qe janë sa më reale, që flasin për histori të vërteta, dhe janë te thjesht-

ta, janë origjinale ... Në repertorin tim kam trajtuar gjithmonë tema sociale në këngët lirike, në këngët patriotike si dhe një vend të veçantë zënë këngët për mërgimtarët, jeta në jashtë vendit tënd. Kam marre gjithmonë krijimtari të reja, nuk kame marre këngët e dikujt tjetër, gjë e cila ka shumë rendësi. Merite të madhe kane edhe ata që kane punuar për mua. Gjej rastin të falënderoj koleget pa përjashtim kompozitor e muzikantët, shpine diskografike “bbf music”, dhe “bassrecords”, si dhe studion filmike të videoklipeve “pawermedia”.

Çfarë duhet të ketë një artist, që të jete artist i vërtet?

Pyetje shume me vend. Në rralle të pare duhet të jete njeri! Pa marr parasysh se çfarë profesioni keni, nëse nuk je njeri, nuk je asgjë. E, nëse je njeri, ke atë ma kryesoren, pastaj ne rastin e një artisti këngëtar, mendoj që duhet të jesh vetvetja, sa më i thjeshte, origjinal. Të jesh unik në atë që bën, pasi në ketë mënyre do të duan më shume, të respektojnë për atë që je realisht se, nëse nuk je vetvetja, koha i hedh maskat në toke, dhe të biesh aty ku nuk duhet, mjafton shume pak.

Pëllumb, në mbyllje një urim tuajin?

Në rralle të pare, ju përshëndes ju si gazetarë, që jeni shume e mire. U ndjeva shume mire, me ju dhe me gjithë zemër ju uroj shume suksese. Puna te mbare i uroj krejt redaksisë së gazetës “Dukagjini” dhe shoqatës “Atdhetare-Dukagjini”, suksese në punën tuaj. Përzemërsisht përshëndes të gjithë fansat e mi kudo që janë, në Shqipëri dhe diasporë. Mire u takofshim në dasma, koncerte dhe gëzime familjare! Edhe njëherë ju faleminderit!

Përgatiti, ARSYELA DELISHAJ

poezi *** poezi *** poezi *** poezi *** poezi*** poezi *** poezi*** poezi *** poezi

KUR RREZET E DIELLIT

Kur rrezet e Diellit që herët në mëngjes
Të ndriçojnë si asnjëherë tjetër Tokën
Unë do të vij përsëri, si domosdoshmëri
Të çmallem me ju, me të gjithë njerëzit e mij.

Së bashku me mua janë “Drita” e “Rrezja”
Ato më zgjuan nga gjumi i përjetësisë
Përtej lartësive është zhdukur errësira
Atje ndodhet Shkelqimi i pafund, Mirësia.

Kam marrë leje, rast unikal tepër i veçantë
“E meritoni një milion herë,- më thanë
Jeta e jote ishte shëmbull, përkushtim
Punë, sakrificë, kurdoherë frymëzim”.

Te “Nënë Tereza”, Spitali Enkologjik, Tiranë
Të sëmurët e pa fat me “gjarpërin” në bark
Në koridore, ditë e natë, presin në radhë
“Mjekimin”, kimio-terapinë, për ta marrë.

Ilaçe edhe sot s’ka, shkoni në farmaci
Me para në dorë, ministria ka ngordh
Të jesh a mos të jesh kjo është çështja
Si flaka e qiririt ndizet e shuhet jeta!

Çdo gjallesë, edhe mbret, një finish e pret
Ai kudo pa mëshirë egersisht godet!
Ah, ilaçet e mia: një togë me “ushtarë”
Në duel me kancerin mbeta e vrarë.

Në datën 12-të, ora 21-një e 20-të, Prill 2013
Zemra pushoi, mbylla sytë përgjithmonë
Në duart e Verës dhe të bashkëshortit tim
Dhashë frymën e fundit, u nisa për në Amshim.

Luigj Temali

NË HYRJË TË POEZI SË SHOSHIT

Sapo erdha nga diaspora
Në vendlindje u përqendrova
E pasi ndodhem këtu në Shkodër
Po e la nji poezi të vogël

Me shekuj e breza t’ pastër pa njolla
Dy yjet e Shoshit të Dukagjinit
Prele Milani Lazer Kodra
Me dhunti të penës së shkrimit

Nji mendimit janë bashkue
Janë fut thelle në kërkime
Kane plotësue çfarë s’ ishte shkruar
E i kane mbjelle në disa vëllime

Për Dukagjinin me dashni e zell
Krejt të plote historinë e moçme
Me krenari e kane përcjell
Deri tash n’kohen e sotme

Me cilësi profesionale
Origjine e rrajë t’praktut
Historinë e burrave n’male
E nga u ka rrjedhe damari i gjakut

E kane shkruar vendin e vet
Në lashtësi e nga themelet
Ma saktësi e objektivitet
Kane nxjerre ndrite identitet

Në gjith periudhat historike
Dukagjinin me lagje e fshatra
Janë rrjeshtue ne shekuj e vite
Me histori e fakte të gjalla

Shkrimtare e deshi Shoshi
Edhe Vila e Shllakut
Shkrimtare e lindi nana
Si t’ishin të nji gjakut

Me ndjenjat e holla
Me cilësitë e shkrimtarit
E qëndisen Dukagjinin
Me fije t’arta arit

Këta i njeh malsia e krejt Shkodra
I njeh Shqipria e diaspora
I dhanë vlerat historisë
Urime n’ rrugën e vazhdimësisë

Gjon Macorri

REDAKSIA

Kryeredaktor: Lazër Kodra

Redaktorë: Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani, Luigj Shyti, Suela Ndoja, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja